

# PERSPEKTIVA GJINORE NË SHQIPËRI



ANALIZA GJINORE  
CENSUS 2011

3 fëmijë për një grua  
1990 në 1.4 fëmijë m

Censusi

23  
vjeç  
marrësen e parë

hendek gjinor  
19%

37,1%



# **PERSPEKTIVA GJINORE NË SHQIPËRI**

Analiza gjinore e rezultateve të censurit 2011  
të popullsisë dhe banesave

tetor 2014

## Mirënjohje

Analiza gjinore e rezultateve të Censurit të popullsisë dhe banesave 2011 u krye falë bashkëpunimit të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Institutit të Statistikave (INSTAT) në kuadër të Programit të Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016.

Falënderime të veçanta u shkojnë ekspertëve, znj. Jessica Gardner dhe znj. Juna Miluka për kontributin e tyre të vyer për këtë studim. Ndihma e tyre në mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave ka qënë me vlerë, duke pasur parasysh kompleksitetin e fushave të mbuluara nga ky studim.

Falënderojmë të gjithë kontribuesit dhe specialistët e INSTAT, z. Gjergji Filipi, Znj. Emira Galanxhi dhe znj. Pranvera Elezi për mbledhjen e të dhënave dhe njohuritë e tyre teknike në hartimin e këtij studimi. Falënderojmë ekipin e Kombeve të Bashkuara, znj. Flora Ismaili, znj. Elsona Agolli (UNFPA) dhe z. Rezart Xhelo (UN Women) për mbështetjen dhe udhëzimin teknik dhe dedikimin e tyre që ky studim të analizojë sa më qartë të dhënat mbi burrat dhe gratë në Shqipëri, dhe të japë mesazhe të rëndësishme për politikën dhe vendmimirin në Shqipëri.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk përfaqësojnë detyrimisht pikëpamjet e UN Women, UNFPA, Kombeve të Bashkuara apo të Qeverisë Shqiptare.

Copyright © UN Women 2014  
UN Women Country Office Albania  
Rr. Skenderbej, Pall. 6, ap. 11-12, Tirana, Albania  
Tel: +355 4 450 2555 / 7575

# Përmbajtja

<b>Mesazhet kryesore</b>	<b>7</b>
<b>Gjetjet kryesore</b>	<b>9</b>
Popullsia, martesë dhe familjet	9
Shëndeti	10
Arsimi	10
Migrimi	11
Puna dhe punësimi	11
<b>Hyrje</b>	<b>13</b>
Rreth raportit	13
Barazia gjinore dhe zhvillimi në Shqipëri	14
Përmirësimi i statistikave gjinore	16
<b>Popullsia, martesë dhe familjet</b>	<b>19</b>
Gjetjet kryesore	21
Martesa	25
Fertiliteti tek adoleshentët	28
Familjet dhe shtëpitë	29
<b>Shëndeti dhe Mirëqenia</b>	<b>33</b>
Gjetjet kryesore	35
Kërkesat për shërbime shëndetësore	36
Aftësia e kufizuar	37
<b>Arsimi</b>	<b>41</b>
Gjetjet kryesore	43
Ndjekja e shkollës	44
Arritjet në arsim	49
Edukimi	52

<b>Migrimi</b>	<b>55</b>
Gjetjet kryesore	57
<b>Puna dhe Punësimi</b>	<b>65</b>
Gjetjet kryesore:	68
Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	69
Llojet e punësimit	71
Kufizimet në fuqinë punëtore	71
Ndarja në profesion dhe industri	74

# Indeksi i tabelave dhe grafikë

## GRAFIKË

Grafiku 1	Piramidat e popullsisë për zonat urbane dhe rurale, Shqipëri, 2011	25
Grafiku 2	Statusi martesor i popullsisë mbi 15, sipas seksit, Shqipëri, 2011	26
Grafiku 3	Raporti i popullsisë që janë të ve, sipas moshës dhe seksit, Shqipëri, 2011	27
Grafiku 4	Raporti i njerëzve të martuar para moshës ligjore 18 vjeç, sipas seksit, Shqipëri, 2011	27
Grafiku 5	Normat e lindjes së adoleshentëve sipas moshës, Shqipëri, 2011	28
Grafiku 6	Statusi arsimor i grave të moshës 15-19 krhasuar me nënat e moshës 15-19, Shqipëri, 2011	29
Grafiku 7	Lloji i familjes bërthamë, Shqipëri, 2011	30
Grafiku 8	Raporti i familjeve me fëmijë të moshave të ndryshme që jetojnë me ta, sipas llojit të familjes, Shqipëri, 2011	31
Grafiku 9	Norma e varësisë së fëmijës dhe të moshuarit sipas prefekturës, Shqipëri, 2011	36
Grafiku 10	Mbizotërimi i aftësisë së kufizuar për popullsinë e përgjithshme të moshës mbi 15, sipas llojit dhe seksit, Shqipëri, 2011	38
Grafiku 11	Mbizotërimi i aftësisë së kufizuar të rëndë, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, seksi dhe grupmosha, Shqipëri, 2011	39
Grafiku 12	Popullsia banuese e moshës 6-24 që po ndjekin aktualisht shkollën, sipas seksit dhe moshës (%) (Normat e Ndjekjes Specifikuar sipas Moshës), Shqipëri, 2011	45
Grafiku 13	Indeksi i Barazisë gjinore (IBGJ) sipas nivelit të ndjekjes së shkollës, Shqipëri, 2011	48
Grafiku 14	Popullsia banuese që nuk e ka ndjekur kurrë shkollën, sipas seksit dhe moshës, (%), Shqipëri, 2011	49
Grafiku 15	Niveli më i lartë i arsimit të përfunduar nga njerëzit që kanë ndjekur shkollën në të shkuarën, sipas seksit, Shqipëri, 2011	50
Grafiku 16	Norma e përfundimit të shkollës së mesme për popullsinë mbi 18, sipas seksit dhe prefekturës, Shqipëri, 2011	51
Grafiku 17	Norma e edukimit tek të rriturit (mosha mbi 15) sipas seksit dhe prefekturës, Shqipëri, 2011	53
Grafiku 18	Arsyet për migrim të brendshëm, sipas zonës dhe seksit, Shqipëri, 2011	59
Grafiku 19	Arsyet për të migruar në Shqipëri nga jashtë sipas zonës dhe seksit	60
Grafiku 20	Banues Jashtë vendit, sipas kombësisë, seksit dhe vendbanimit të zakonshëm (numri që ka jetuar jashtë vendit për një vit ose më shumë), Shqipëri, 2011	62

Grafiku 21	Normat e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, sipas seksit, Shqipëri, 2007-2011	70
Grafiku 22	Arsyet për pasivitet ekonomik, sipas seksit, Shqipëri 2011	71
Grafiku 23	Llojet e punësimit, sipas seksit, Shqipëri, censusi 2011	72
Grafiku 24	Normat e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore, sipas numrit të fëmijëve dhe moshës	72
Grafiku 25	Orët e punës, sipas seksit, Shqipëri, 2011	76

## TABELA

Tabela 1	Pasqyrë e popullsisë shqiptare më 2011	23
Tabela 2	Statusi arsimor i fëmijëve me aftësi të kufizuar, sipas seksit, Shqipëri, 2011	40
Tabela 3	Normat e ndjekjes neto dhe bruto, sipas nivelit të shkollimit, Shqipëri, 2011	47
Tabela 4	Normat e edukimit tek të rinjtë dhe të rriturit, sipas seksit, Shqipëri 2011	53
Tabela 5	Arsyet e Ardhjes për të jetuar në Shqipëri, sipas vendlindjes dhe seksit, 2011	61
Tabela 6-7	Qytetarë shqiptarë banues jashtë vendit që janë kthyer pas 1 Janarit 2001 sipas seksit, grupmoshës, dhe vitit të kthimit, Shqipëri, 2011	63-64
Tabela 8	Popullsia ekonomiksht aktive, sipas nivelit arsimor të arritur dhe seksit	73
Tabela 9	Përqindja e burrave/grave në çdo profesiona (në %), Shqipëri, 2011	74
Tabela 10	Përqindja e punësimit sipas sektorëve, Shqipëri, 2011	75



# Mesazhet kryesore

- Ky botim siguron një analizë gjinore të të dhënave të 2011-s për popullsinë dhe banesat të botuara më 2014.
- Përmban fakte të rëndësishme për politikën dhe vendimmarrësit që punojnë mbi çështjet gjinore dhe të zhvillimit dhe i shtohet gamës në rritje të statistikave gjinore të disponueshme për Shqipërinë.
- Ka një sasi në rritje të të dhënave të lidhura me gjininë që prodhohet nëpërmjet censusve, anketave dhe regjistrave administrativë.
- Rekomandime të veçanta janë dhënë për të përforcuar më tej statistikat gjinore në Shqipëri.
- Struktura moshë-seks e popullsisë shqiptare po ndryshon si pasojë e normave të fertilitetit, migrimit rural-urban dhe ndërkombëtar dhe jetëgjatësisë në rritje.
- Ndryshimet në përbërjen e familjeve dhe të shtëpive mund të zbulojnë çështje të rëndësishme gjinore, si rritja e numrit të divorceve, veçëria dhe mbizotërimi i familjeve me një prind.
- Normat e martesës, përmasat e familjes dhe përbërja e shtëpive ndikon në ndarjen e punës dhe rolet që gratë dhe burrat luajnë në shoqëri.
- Censusi i popullsisë mbledh informacion të kufizuar në lidhje me shëndetin.
- Dinamikën e popullsisë, si plakja dhe migrimi në zonat urbane, do të ndikojnë në kërkesën për shërbime shëndetësore.
- Gratë kanë më shumë gjasa të kenë një aftësi të kufizuar se burrat. Ky hendek gjinor ndodh me shumë gjasa prej marrëdhënies midis aftësisë së kufizuar dhe vjetërsisë, dhe faktit që gratë kanë tendencën të jetojnë më gjatë dhe përbëjnë shumicën e popullsisë së moshuar.
- Rreth 20% e fëmijëve me aftësi të kufizuar nuk e kanë ndjekur shkollën, krahasuar me 2% të fëmijëve 6-14 vjeç. Situata është disi më e rëndë për djemtë me aftësi të kufizuar.
- Censusi dëshmon një etapë të rëndësishme të progresit në aksesin dhe rezultatet në arsimim.

- Sistemi arsimor duket sikur ka arritur shumicën e vajzave dhe të djemve, pa një hendek gjinor të konsiderueshëm në ndekje mes moshave 6 deri 17.
- Nivelet e ndjekjes së shkollës, arritjet në mësim dhe edukimi (shkrim-leximi) kanë qenë të qëndrueshëm në dekadën e fundit.
- Nivelet më të ulëta të arsimimit të grave, në veçanti të grave në fshat, sugjerojnë që edukimi funksional dhe aftësitë numerike mund të jenë të varfëra dhe si rrjedhojë, edhe mundësitë e tyre për punësim dhe sipërmarrje janë më të kufizuara se për burrat.
- Prirjet për migrim kanë ndryshuar, duke rritur rëndësinë e analizës së rregullt të statistikave të lidhura me të.
- Migrimi duhet të studiohet me lente gjinore për të siguruar një të kuptuar më të mirë për dimensionin gjinor dhe ndikimin e tij.
- Migrimi ndërkombëtar ishte kryesisht mashkullor në të kaluarën, por ky nuk është më rasti. Emigrimi femëror është rritur si pasojë e bashkimeve familjare dhe mundësive më të mira jashtë vendit.
- Më shumë se 20 vjet më parë, kishte një migrim të jashtëm masiv; tani emigrantët po kthehen në Shqipëri.
- Gratë kanë më shumë gjasa të emigrojnë së brendshmi se burrat, me shtysën kryesore atë të arsyeve familjare.
- Gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së vendit por vetëm një të tretën në punësim.
- Edhe pse Shqipëria ka parë një rritje ekonomike në vitet e fundit, pozita e grave në tregun e punës vazhdon të mbetet mbrapa me atë të grave në shtetet e Bashkimit Evropian (BE).
- Gratë janë të përqendruara në sektorë dhe profesione që ofrojnë rroga të ulëta krahasuar me sektorë të mbizotëruar nga burrat.
- Varësia ekonomike ndaj të tjerëve mund të rrisë cënueshmërinë e grave, e cila si rrjedhojë mund të ndikojë në mirëqenien ekonomike të fëmijëve të tyre.
- Gratë janë të nënpërfaqësuar midis ligjvënësve, zyrtarëve të lartë dhe menaxherëve dhe si rrjedhojë kanë mundësi të kufizuara për t'u përfshirë drejtpërdrejt në vendimmarrje.
- Anketat e fuqisë punëtore bëhen vazhdimisht në Shqipëri dhe sigurojnë një matje më të saktë të aktivitetit ekonomik se censusi i popullsisë.

# Gjetjet kryesore

## Popullsia, martesat dhe familjet

- Norma e ulët e lindjeve, rritja e jetëgjatësisë dhe shkalla e lartë e emigrimit po e çojnë Shqipërinë drejt tregimit të shenjave e të pasurit një popullsi në plakje.
- Të dhënat e fertilitetit kanë rënë nga 3 fëmijë për një grua më 1990 në 1.4 fëmijë më 2008.
- Raporti i seksit në lindje është 107.8 meshkuj për 100 femra – më i lartë se raporti i përgjithshëm i raportit të seksit për të gjitha moshat me 100 meshkuj për 100 femra.
- Ka një dallim minimal në strukturën moshë-seks të popullsisë në zonat urbane kundrejt atyre rurale.
- Moshat mesatare në martesën e parë është 23 vjeç për gratë dhe 29 për burrat. Krahasimet në censusin e 2011-s sugjerojnë që moshat në martesën e parë është rritur lehtë si për gratë dhe për burrat.
- Midis popullsisë 15 vjeç e lart, 32% e burrave nuk janë martuar kurrë në krahasim me 23% të grave.
- Midis 214,000 njerëzve të moshuar (70 vjeç e lart) më shumë se gjysma e grave (56%) janë të veja krahasuar me 14% të burrave.
- Më shumë se 400 vajza dhe djem 15-vjeçarë janë tashmë të martuar, duke përfaqësuar 2% të njerëzve në atë grupmoshë.
- Të dhënat për martesën midis 16 dhe 17-vjeçarëve tregojnë që martesat e hershme është më mbizotëruese për gratë se sa burrat.
- Normat e fertilitetit tek adoleshentët janë të ulëta (14.9 lindje për 1000 gra të moshës 15-19 vjeç) por kjo mund të jetë në rritje. Pothuajse 3% e vajzave adoleshente kanë lindur.
- Pak nëna adoleshente mbeten në shkollë (8%) ndërsa shumica e vajzave të moshës 15-19 (69%) vazhdojnë e ndjekin.
- Familjet me një prind po rriten, duke përbërë 8% të të gjitha njësisve familjare (deri në 7% në 2011), me shumicën (84%) që janë nëna të vetme.

## Shëndeti

- Migrimi nga zonat rurale në urbane dhe një popullsi në plakje do të rrisë presionin për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.
- Janë afërsisht dy njerëz në moshë pune për çdo fëmijë/të moshuar në varësi.
- Mbizotërimi i aftësisë së kufizuar lidhet ngushtë me plakjen dhe është më i lartë ndër gratë.
- Vështirësitë në shikim dhe në ecje janë format më të zakonshme të aftësisë së kufizuar si për gratë ashtu dhe burrat.

## Arsimi

- Ndjekja shkollës është e lartë ndër 6-14 vjeçarë dhe nuk ka ndonjë hendek gjinor të dukshëm.
- Djemtë po e lenë arsimin zyrtar që nga mosha 18 vjeç me norma më të shpejta se vajzat.
- Gratë e moshuara kanë më shumë gjasa të mos jenë arsimuar.
- Shumica e burrave dhe grave kanë mbaruar të paktën shkollën fillore; 85% e burrave dhe 80% e grave 15 vjeç e lart.
- Më pak se gjysma e popullsisë së Shqipërisë 18 vjeç e lart ka mbaruar arsimin e mesëm: rreth 41% e grave dhe 48% e burrave.
- Më 2011, numri mesatar i viteve që njerëzit kanë mbaruar shkollimin është 10, me asnjë ndryshim mes burrave dhe grave.
- Hendeku arsimor mes burrave dhe grave është më i dukshëm në zonat rurale, me më pak se një të katërtën (23%) e grave në zonat rurale që kanë mbaruar arsimin e mesëm, krahasuar me më shumë së gjysmën (56%) e grave në zonat urbane.
- Edukimi tek të rriturit mbetet i lart me një hendek gjinor të lehtë që konsiston; 96% e burrave dhe 94% e grave 15 vjeç e lart janë në gjendje të lexojnë dhe të shkruajnë në një ose më shumë gjuhë.

## Migrimi

- Arsyet familjare janë shtysa kryesore si për burrat ashtu dhe gratë për të migruar brenda vendit.
- Arsyet për t'u kthyer nga jashtë vendit ndryshojnë ndërmjet burrave dhe grave. Burrat kthehen kryesisht pasi mbarojnë punën jashtë vendit; midis grave është kryesisht për arsye familjare.
- Më shumë burra Shqiptarë kanë jetuar jashtë vendit për një vit ose më shumë, se gra Shqiptare.
- Greqia dhe Italia vazhdojnë të mbeten dy destinacionet për vendbanim jashtë vendit si për burrat ashtu dhe për gratë.
- Prirja e kthimit të emigrantëve në Shqipëri ka qenë në rritje për të dyja sekset, edhe pse meshkujt përbëjnë shumicën e emigrantëve të kthyer që nga janari 2001.
- Një pjesë e vogël e banorëve shqiptarë kanë imigruar në Shqipëri nga shtetet e tjera, kryesisht nga Greqia dhe Italia.
- Me përjashtimin e atyre që kanë lindur në Turqi, burra dhe gra të lindur jashtë vendit që vijnë të jetojnë në Shqipëri, e bëjnë për arsye familjare. Në rastin e Turqisë ka një dallim gjinor, me burrat që vijnë në Shqipëri për mundësi punësimi dhe gratë për arsye familjare.

## Puna dhe punësimi

- Më pak gra marrin pjesë në fuqinë punëtore; 60.8% e grave krahasuar me 76.4% e burrave (Anketa e Fuqisë Punëtore 2011).
- Pjesëmarrja në fuqinë punëtore është rritur lehtë që në 2007 kur 56.2% e grave dhe 74.4% e burrave ishin në fuqinë punëtore (Anketa e Fuqisë Punëtore 2011).
- Censusi 2011 për popullsinë tregon nivel shumë më të ulët të aktivitetit ekonomik me 37.1% të grave dhe 62.4% të burrave në fuqinë punëtore. Megjithatë, metodologji të ndryshme të përdorura në census krahasuar me anketat e fuqisë treguan që disa lloje pune nuk ishin llogaritur.
- Gratë kanë prirje të jenë të përqendruara në një lloj të caktuar pune. Burrat kanë më shume gjasa të jenë punëdhënës ose të vetëpunësuar dhe gratë kanë gjasa të jenë të punësuar ose të kryejnë punë të papaguar në një biznes familjar.

- Arsyet e dhëna për të mos qenë në fuqinë punëtore (p.sh. i punësuar ose i papunë) ndryshojnë gjerësisht ndërmjet grave dhe burrave. Për gratë është kryesisht sepse janë shtëpiake me kohë të plotë (49%), por për burrat është sepse janë studentë (32%) ose sepse besojnë që nuk ka punë të disponueshme (28%).
- Gratë që nuk kanë fëmijë kanë shkallë më të lartë të aktivitetit ekonomik. Ndërsa numëri i fëmijëve rritet, aktiviteti ekonomik zakonisht bie, sidomos për gratë me katër ose më shumë fëmijë.
- “Profesionistët” është grupimi më i madh i profesioneve që mbizotërohet nga gratë (61% janë gra).
- Profesionet e mbizotëruara nga meshkujt janë zejtaria dhe tregtia e lidhur me të, operatorë dhe montues në fabrika dhe të makinerive, dhe forcat e armatosura.
- Gratë e punësuar janë kryesisht të përqendruara në sektorin e shërbimeve (kundrejt bujqësisë dhe industrisë) ku ato mbajnë 42% të këtyre punëve.
- Burrat punojnë me orar më të zgjatur në punë në krahasim me gratë, me pothuajse gjysmën e tyre (45%) që punojnë 40 orë ose më shumë në javë. Gratë raportojnë orar të ngjashëm, por kanë më shumë gjasa ta mbajnë orarin e punës në 36-40 orë në javë.

# Hyrje

## Mesazhet kryesore:

- Ky botim siguron një analizë gjinore të të dhënave të censurit të 2011-s për popullsinë dhe banesat, të botuara më 2014.
- Përmban fakte të rëndësishme për politikëbërësit dhe vendimmarrësit që punojnë me çështjet gjinore dhe të zhvillimit dhe i shtohet gamës në rritje të statistikave gjinore të disponueshme për Shqipërinë.
- Ka një sasi në rritje të të dhënave të lidhura me gjininë që prodhohet nëpërmjet censuseve, anketave dhe regjistrave administrativë.
- Rekomandime të veçanta janë dhënë për të përforcuar më tej statistikat gjinore në Shqipëri.

## Rreth raportit

Rolet që gratë dhe burrat luajnë në shtëpi, në komunitet dhe në shoqërinë e tërë janë duke evoluar. Ndryshimet e shpejta shoqërore e bëjnë edhe më të rëndësishëm vazhdimin e monitorimit të pabarazive gjinore ndër sektorët socialë, ekonomikë dhe mjedisorë. Statistikat zyrtare sigurojnë faktet kaq të nevojshme për të adresuar çështjet gjinore nëpërmjet politikave dhe programeve kombëtare; një pjesë thelbësore e qeverisjes së mirë. I zbatuar çdo 10 vjet, censusi i popullsisë dhe banesave siguron një arritje të vlefshme për monitorimin e barazisë gjinore. Censusi 2011 përfshihet një gamë pyetjesh rreth shtëpive Shqiptare dhe njerëzve që jetojnë në to. Të dhënat janë mbledhur nga çdo person në vend, duke dhënë mundësinë për një analizë të detajuar gjinore. Kjo monografi gjinore është në vazhdimësi të Raportit Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave (RKBJSG), i cili siguron një analizë gjithëpërfshirëse gjinore bazuar në një gamë burimesh të dhënash. Ndryshe nga raporti kombëtar, ky publikim fokusohet në analizën e një burimi të vetëm të dhënash: censusi 2011 për popullsinë dhe banesat, rezultatet e të cilit nuk ishin botuar plotësisht në kohën kur u përgatit raporti kombëtar.

Censusi për popullsinë dhe banesat siguron të dhëna mbi:

- Martesën dhe familjet
- Përmasat e shtëpisë
- Arsimin
- Edukimi
- Pjesëmarrjen në fuqinë punëtore
- Migrimin
- Aftësinë e kufizuar

Për të siguruar që bollëku i informacionit nga censusi po përdoret në efektin maksimal, Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) ka punuar me INSTAT për të prodhuar këtë publikim. Ky i shtohet analizave gjinore ekzistuese dhe shton në bazën faktike në rritje për ngjashmëritë dhe dallimet midis grave dhe burrave, vajzave dhe djemve Shqiptarë.

Ky raport synon jo statisticienët dhe duhet të jetë tërheqës për këdo të interesuar për gjininë dhe zhvillimin në Shqipëri. Gjetjet janë prezantuar në mënyrë të tillë që e lejojnë lexuesin të përvetësojë dhe të zbatojë gjetjet në advokim, zhvillimin e politikave dhe vendimmarrjen.

## **Barazia gjinore dhe zhvillimi në Shqipëri**

Një numër çështjesh gjinore vazhdojnë t'i ndodhin popullit Shqiptar. Ndërsa aksesit në arsim po përmirësohet, më shumë gra të reja se burra po humbasin mundësinë për një arsim të plotë fillorë dhe të mesëm. Uljet e ndjeshme në vdekshmërinë foshnjore tregojnë përmirësim në ofrirmin e shërbimeve shëndetsore, por nevojitet më shumë për të siguruar që gratë shtatzënë të marrin kujdesin e duhur para lindjes dhe që vdekshmëria e nënave të ulet edhe më tej, si dhe të adresohen çështjet e shëndetit të burrave.

Tregu i punës vazhdon të mbizotërohet nga meshkujt, me më pak gra të angazhuara në punësim dhe shumica prej tyre në punë janë në profesionet më pak të paguara. Rritja e përfaqësimit të grave në politikëbërje dhe vendimmarrje dhe eliminimi i dhunës në familje dhe me bazë gjinore janë gjithashtu prioritete kyçe për arritjen e barazisë gjinore.



Shqipëria ka një nivel të lartë të zhvillimit njerëzor dhe është renditur e 70-a në 2012 nga 186 shtete.<sup>1</sup> Vendi karakterizohet nga mosbarazitë urbane-rurale, shifra të larta të emigrimit dhe një treg pune që ka ndjerë lëkundjet e krizës së fundit botërore finaciare. Indeksi i pabarazisë gjinore (IPGJ) është një matje e përbërë e pabarazisë ndërmjet grave dhe burrave bazuar në shëndetin riprodhues, fuqizimin dhe tregun e punës. Në 2012 IPGJ-ja e Shqipërisë ishte 0.251 (sa më e ulët aq më mirë), që e radhiti të 40-n krah shteteve si Shtetet e Bashkuara (0.256) dhe Hungaria (0.256). Në krahasim, IPGJ-ja e Italisë ishte 0.094 dhe ata u radhitën të 11-t, kryesisht nga shifrat e ulëta të vdekshmërisë së nënave, fertilitetit tek adoleshentët dhe përfaqësisë së madhe të grave në parlament. Edhe pse progresi ka qenë i konsiderueshëm, është e qartë që ka ende hendekë gjinorë.

Barazia gjinore dhe të drejtat e grave janë kyçe ndër prioritetet kombëtare. Ratifikimi i konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW), si dhe dekretimi i ligjeve për barazinë gjinore, diskriminimin dhe dhunën në familje, janë të gjitha fakte për këtë përkushtim. Këto dhe miratimi i një strategjie kombëtare mbi barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje (SKBGJ-DHBGJ-DHF) sigurojnë një kuadër për arritjen e qëllimeve kombëtare. Thelbësore për këtë është prodhimi i rregullt dhe përdorimi i statistikave të lidhura me gjininë, një fushë ku sistemi zyrtar shqiptar i statistikave po bën një progress domethënës.

## KUTIA 1

### Çfarë është gjinia?

Gjinia lidhet me rolet që gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë luajnë në shoqëri dhe aty ku ekzistojnë ngjashmëritë dhe dallimet përtej atyre të bazuara në seksin biologjik. Gjinia është një konstrukt shoqëror që ndikon ndarjen e punës midis grave dhe burrave, aksesin në edukim, llojet e punës dhe punësimin që njerëzit kanë, aksesin në të ardhurat dhe pasuritë e familjes, shëndetin dhe migrimin. Gjinia nuk ka të bëjë vetëm me gratë; është si për burrat dhe për gratë.

**Seksi:** Karakteristikat biologjike dhe fiziologjike që përcaktojnë burrat dhe gratë.

- Femër dhe mashkull
- Përcaktohet nga biologjia
- Relativisht i pandryshueshëm

**Gjinia:** rolet, sjelljet, aktivitetet dhe vetitë të konsideruara të përshtatshme për burrat dhe gratë.

- Femërore dhe mashkullor
- Përcaktohet nga normat shoqërore
- Shpesh ndryshon me kohën dhe ka dallim midis shteteve

1 Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), 2013. Zhvillimi Njerëzor 2013: Ngritja e Jugut – Zhvillimi Njerëzor në një Botë me Diversitet.

## Përmirësimi i statistikave gjinore

Disponueshmëria e kufizuar e të dhënave të ndara sipas seksit është një kritikë shpesh e bërë ndaj sistemit të statistikave kombëtare. Shpesh këto të dhëna mblidhen, por nuk analizohen ose publikohen në një formë që përputhet me nevojat e përdoruesve të të dhënave. Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) është fokusuar në përmirësimin e disponueshmërisë të të dhënave të ndara sipas seksit në të gjitha publikimet e tij statistikore. Kjo tregohet në publikimet ekzistuese të censusit, ku një burim i pasur i të dhënave të ndara sipas seksit është e disponueshme dhe në publikimet e rregullta të statistikave gjinore, si seritë e Femra dhe Meshkuj në Shqipëri.

Një grupim kombëtar i treguesve të harmonizuar gjinorë (THGJ) u përshtat nga qeveria më 2010, duke përfaqësuar një hap të rëndësishëm përpara në përmirësimin e cilësisë të statistikave gjinore. Këta tregues janë mjeti zyrtar për monitorimin e progresit drejt qëllimeve të barazisë gjinore dhe raportimi kundrejt tyre është fokusi i Raportit të parë Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave, të publikuar më 2012.

Të dhënat e censusit janë të dobishme për të ndjekur progresin drejt qëllimeve kombëtare të barazisë gjinore, në veçanti, të atyre të lidhura me arsimin, statusin ekonomik dhe migrimin. Megjithatë, ky është vetëm një nga burimet e ndryshme të rëndësishme për statistikave gjinore në Shqipëri. Të tjerat përfshijnë:

- **Anketa e përdorimit të kohës në Shqipëri 2011**  
të dhëna se si njerëzit e shpenzojnë kohën e tyre në punën e paguar, punën e papaguar dhe në aktivitetet e kohës së lirë
- **Që nga 2007 Anketa e Fuqisë Punëtore**  
të dhëna për statusin e punësimit dhe aktivitetet ekonomike
- **2002, 2005, 2008 dhe 2012 Anketa për Matjen e Standartit Shqiptar të Jetesës (MSSHJ)**  
të dhëna se sa të ardhura fitohen, për çfarë i shpenzon një familje paratë dhe kushtet e jetesës në të gjithë vendin
- Anketa e Buxhetit të Familjes 2006-2007
- **2008-2009 Anketa e Demografisë dhe Shëndetit**  
të dhëna mbi fertilitetin, shëndetin riprodhues, shëndetin e fëmijës, ushqimin dhe HIV/SIDA
- **2007 dhe 2013 Anketat e Dhunës në Familje**  
siguron të dhëna thelbësore mbi përhapjen dhe qëndrimeve ndaj dhunës me bazë gjinore

- **Të dhëna administrative** të mbledhura nga ministrinë e shëndetit, arsimit, etj.

Bashkë, këto anketa, censuse dhe regjistra administrative u sigurojnë vendimmarrësve dhe politikëbërësve fakte rreth realiteteve të jetës për njerëzit përreth Shqipërisë. Edhe pse shumë ekziston, ka fusha ku mbledhja dhe analizimi i të dhënave ka ende nevojë për përmirësim. Kjo monografi gjinore është një ndër të parat që prodhohet në rajon për censuset e 2011 të popullsisë dhe banesave. Kjo luan një rol kyç në përforcimin e statistikave gjinore.

**Rekomandimet** për përforcimin e mëtejshëm të statistikave gjinore në Shqipëri përfshijnë:

1. Edukimi i komunikimit dhe të kuptuarit midis prodhuesve të të dhënave dhe përdoruesve, nëpërmjet dialogut të rregullt dhe sistematik dhe ndarjes së informacionit.
2. Prodhimi i përmbledhjeve të fokusuara tek gjinia për të shoqëruar publikimin e rezultateve për censusat dhe anketat e ardhshme, si anketat për fuqinë punëtore dhe anketat për standartet e jetesës.
3. Identifikimi dhe adresimi i hendekëve të të dhënave, si në fushat e shëndetit, sigurimit shoqëror, varfërisë, sektorit joformal dhe të pronësisë dhe kontrollit të burimeve.<sup>2</sup>
4. Ndarja e statistikave zyrtare sipas grupeve në nevojë dhe minoriteteve.
5. Të punuarit me universitetet dhe institucionet lokale për të forcuar kërkimin mbi çështjet gjinore. Puna e fundit e INSTAT-it për kalimin e të dhënave mikro tek komuniteti kërkimor dhe publiku është një hap i shkëlqyer përpara për të rritur mundësitë për analizë gjinore.
6. Përputhja e standarteve kombëtare me përpjekjet botërore dhe rajonale për të përmirësuar statistikën gjinore, si grupimi kryesor i treguesve të miratuar nga Komisioni i Statistikave të Kombeve të Bashkuara, metodologjitë e reja për matjen e fuqizimit ekonomik dhe rishikimi i kuadrit për prodhimin e statistikave mbi punën, punësimin dhe punën e nënshfrytëzuar.

---

2 Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) dhe UN Women, 2012. Raporti Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave.







## Popullsia, martesë dhe familjet

### Mesazhet kryesore:

- Struktura moshë-seks e popullsisë Shqiptare po ndryshon si pasojë e normave të fertilitetit, migrimit rural-urban dhe ndërkombëtar dhe jetëgjatësisë në rritje.
- Ndryshimet në përbërjen e familjeve dhe të shtëpive mund të zbulojnë çështje të rëndësishme gjinore, si rritja e numrit të divorceve, veçëria dhe mbizotërimi i familjeve me një prind.
- Normat rreth martesës, përmasat e familjes dhe përbërja e shtëpive ndikon në ndarjen e punës dhe rolet që gratë dhe burrat luajnë në shoqëri.

Shoqëria formohet nga populli i saj dhe karakteristikat e tyre – numri i njerëzve, moshë e tyre, seksi, statusi martesor, kushtet e jetesës dhe kështu me radhë. Ky kapitull na jep një pikturë të gjerë të popullsisë në Shqipëri në kohën e censusit 2011, me theks në çështjet e rëndësishme gjinore. Aty ku është praktike, plotësohet nga të dhëna prej burimeve të tjera për të siguruar pikturën e plotë.

### Gjetjet kryesore

- Norma e ulët e lindjeve, rritja e jetëgjatësisë dhe shkalla e lartë e emigrimit po e çojnë Shqipërinë drejt tregimit të shenjave e të pasurit një popullsi në plakje.
- Të dhënat e fertilitetit kanë rënë nga 3 fëmijë për një grua në 1990 në 1.4 fëmijë në 2008.
- Raporti i seksit në lindje është 107.8 meshkuj për 100 femra – më i lartë se raporti i përgjithshëm i raportit të seksit për të gjitha moshat me 100 meshkuj për 100 femra.
- Ka një dallim minimal në strukturën moshë-seks të popullsisë në zonat urbane kundrejt atyre rurale.

- Mosha mesatare në martsën e parë është 23 vjeç për gratë dhe 29 për burrat. Krahasimet në censusin e 2011-ës sugjerojnë që mosha në martesën e parë është rritur lehtë si për gratë dhe për burrat.
- Midis popullsisë 15 vjeç e lart, 32% e burrave nuk janë martuar kurrë në krahasim me 23% të grave.
- Midis 214,000 njerëzve të moshuar (70 vjeç e lart) më shumë se gjysma e grave (56%) janë të veja krahasuar me 14% të burrave.
- Më shumë se 400 vajza dhe djem 15 vjeçarë janë tashmë të martuar, duke përfaqësuar 2% të njerëzve në atë grupmoshë.
- Të dhënat për martesën midis 16 dhe 17 vjeçarëve tregojnë që martesë e hershme është më mbizotëruese për gratë se sa burrat.
- Normat e fertilitetit tek adoleshentët janë të ulëta (14.9 lindje për 1000 gra të moshës 15-19 vjeç) por kjo mund të jetë në rritje. Pothuajse 3% e vajzave adoleshente kanë lindur.
- Pak nëna adoleshente mbeten në shkollë (8%) ndërsa shumica e vajzave të moshës 15-19 (69%) vazhdojnë e ndjekin.
- Familjet me një prind po rriten, duke përbërë 8% të të gjitha njësive familjare (deri në 7% në 2011), me shumicën (84%) që janë nëna të vetme.

Shqipëria ka një popullsi prej pothuajse 3 milionë njerëz me 50.1% që janë meshkuj dhe 49.9% femra. Censusi i 2011-ës tregoi për herë të parë që shumica e njerëzve jetojnë tanimë në zonat urbane (54%), duke pasuar nga një prirje e migrimit rural-urban dhe rritje e qendrave urbane. Prirja për të jetuar në qendrat urbane është pothuajse e njëjtë për grate dhe burrat; 54% e grave jetojnë në zonat urbane dhe 53% e burrave. Nuk ka dallime të rëndësishme ndërmjet normave për migrimin e brendshëm të grave dhe burrave, edhe pse arsyet e tyre për ta bërë këtë variojnë pak. Migrimi i brendshëm dhe ndërkombëtar eksplorohet në kapitullin pesë.



**Tabela 1****PASQYRË E POPULLSISË SHQIPTARE NË 2011**

	<b>Totali</b>	<b>Meshkuj</b>	<b>Femra</b>	<b>Raporti i seksit</b>	<b>% e popullsisë totale</b>
<b>Shqipëri</b>	<b>2,800,138</b>	<b>1,403,059</b>	<b>1,397,079</b>	<b>100</b>	<b>100%</b>
Urbane	1,498,508	742,671	755,837	98	54%
Rurale	1,301,630	660,388	641,242	103	46%
Berat	141,944	71,460	70,484	101	5%
Dibër	137,047	69,825	67,222	104	5%
Durrës	262,785	132,289	130,496	101	9%
Elbasan	295,827	148,791	147,036	101	11%
Fier	310,331	156,959	153,372	102	11%
Girokastër	72,176	36,542	35,634	103	3%
Korçë	220,357	111,325	109,032	102	8%
Kukës	85,292	42,999	42,293	102	3%
Lezhë	134,027	67,097	66,930	100	5%
Shkodër	215,347	106,851	108,496	98	8%
Tiranë	749,365	370,587	378,778	98	27%
Vlorë	175,640	88,334	87,306	101	6%

Raporti i seksit është numri i meshkujve pjesëtuar me numrin e femrave dhe shumëzuar me 100. Një raport me 100 do të thotë që ka numër të barabartë të meshkujve dhe femrave; më pak se 100: më shumë femra se sa meshkuj; mbi 100: më shumë meshkuj se sa femra.

*Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

Siç tregohet në Tabelën 1, prefektura më e populluar është Tirana (27%), e ndjekur nga Elbasani dhe Fieri (të dyja me 11% të popullsisë kombëtare). Më të voglat janë Gjirokastra dhe Kukësi, secila me rreth 3% të popullsisë kombëtare.


Për një vend të karakterizuar më parë nga një popullsi relativisht e re, norma e ulët e lindjeve, rritja e jetëgjatësisë dhe normat e larta të emigrimit të rinjve po e çojnë Shqipërinë që tani të tregojë shenja e të pasurit një popullsi në plakje. Normat e fertilitetit kanë rënë nga 3 fëmijë për grua në 1990 në 1.4 fëmijë në 2008.<sup>3</sup> Ndryshimi ndërmjet numrit të meshkujve dhe femrave shprehet zakonisht si raporti i seksit. Për sa i përket prirjeve botërore, ekzistojnë faktorë biologjikë dhe të jashtëm që ndikojnë në raportin e seksit në lindje dhe përgjatë popullsisë së përgjithshme. Në Shqipëri, censusi 2011 tregoi që janë 107.8 djem të lindur për 100 vajza, paksa më e lartë se sa norma biologjike 102-103.<sup>4</sup> Kur raporti i seksit në lindje është më i madh se 107 kjo sugjeron që faktorët jo biologjikë mund të jetë të përfshirë, si nën raportimi i lindjeve të femrave, ose zgjedhja e seksit para lindjes e lidhur me preferencën për djem.

Në popullsinë në tërësi ka një raport të barabartë meshkujsh dhe femrash, me raportin e seksit prej 100. Kjo barazi e raportit të seksit në lindje krahasuar me popullsinë në tërësi lidhet me prirjen e grave për të jetuar më gjatë se burrat. Raporti i seksit varion lehtë ndërmjet prefekturave, me Dibrën që regjistron ndryshimin më të lartë me 104 meshkuj për 100 femra.

Piramida e popullsisë e treguar në Grafikon 1 tregon këtu një ndryshim minimal në strukturë moshë-seks të popullsisë në zonat urbane kundrejt atyre rurale. Pabarazia më e dukshme është raporti më i madh i të rinjve të moshës 15-19 i vënë re në popullsinë rurale. Si meshkujt dhe femrat në këtë grupmoshë kanë prirje të qëndrojnë në shtëpi me prindërit ose me të afërt të tjerë. Ka relativisht më pak 20-24 vjeçarë në zonat rurale se në ato urbane, në veçanti është kështu për gratë, duke sinjalizuar që kjo është pika kur të rinjtë lëvizin në qendrat urbane ose jashtë vendit për të ndjekur arsimimin dhe mundësi të tjera ekonomike.

3 MPÇSSH dhe UN Women. 2012. Raporti Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave.

4 Zyra për Komisionerin e Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR, UNFPA, Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara (UNICEF), UN Women dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) (2011). Parandalimi përzgjedhjes së seksit të ndikuar nga gjinia. Një deklaratë ndërinstytucionale. Gjenevë, OBSH.

**Grafiku 1****PIRAMIDAT E POPULLSISË PËR ZONAT URBANE DHE RURALE, SHQIPËRI, 2011**

*Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*


Migrimi ka një ndikim të rëndësishëm në popullsinë Shqiptare. Si popullsia urbane dhe ajo rurale tregojnë një ngushtim në mes të piramidës për moshën 30-39 vjeç. Kjo është si rezultat e normës së lartë të emigrimit nga Shqipëria të këtyre grupmoshave. Parashikimet tregojnë që, ndërmjet vitit 2001 dhe 2011, megjithëse më shumë se 100,000 Shqiptarë janë kthyer, ka një humbje neto të më shumë se 370,000 njerëzish që janë largar nga vendi. Ndryshe nga e kaluara, prirja për të emigruar në Itali, Greqi dhe në vende të tjera, është e ngjashme midis burrave dhe grave. Prej emigrantëve që janë larguar midis 2001-2011, gjysma ishin gra (49%). Çështjet gjinore në migrimin ndërkombëtar dhe të brendshëm do të diskutohen duke filluar nga faja 19.

## Martesa

Censuri mbledh informacion për statusin martesor për këdo të moshës 15 vjeç e lart. Rezultatet tregojnë dallime të rëndësishme në situatën e burrave dhe grave, mbi të gjitha si pasojë e prirjes së burrave për t'u martuar më vonë dhe të grave për të jetuar më gjatë dhe si rrjedhojë për të pasur më shumë gjasa për të qenë të veja. Mosha mesatare për martesën e parë është 23 vjeç për gratë dhe 29 për burrat. Censuri i popullsisë 2011 tregoi se shumica e grave ishin martuar në moshën 20 vjeçare dhe për burrat moshë ishte 26. Midis popullsisë 15 vjeç e lart ka një raport më të madh të burrave që nuk janë martuar kurrë: 32 për qind krahasuar me 23 për qind të grave (Grafiku 2).


Grafiku 2

## STATUSI MARTESOR I POPULLSISË MBI 15, SIPAS SEKSIT, SHQIPËRI, 2011




Burim: *Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

Siç shikohet në grafikët mësipër, një raport më i madh i grave mbi moshën 15 vjeç janë të veja në krahasim me burrat. Vejëria siç duket rritet me moshën, siç ilustron në Grafikon 3 më poshtë. Në fakt, për grupmoshën 70 vjeç dhe lart (rreth 214,000 njerëz) më shumë se gjysma e grave (56%) janë të veja krahasuar me vetëm 14 për qind të burrave të moshuar. Të qenit e ve mund t'i vendosë gratë në një pozicion të cënueshëm duke rritur varësinë e tyre ekonomike dhe sociale ndaj të tjerëve.

**Grafiku 3****RAPORTI I POPULLSISË QË JANË TË VE, SIPAS MOSHËS DHE SEKSIT, SHQIPËRI, 2011**

Burim: *Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

Martestat e hershme nuk janë mbizotëruese në Shqipëri, por statistikat e deritanishme sigurojnë informacion të rëndësishëm mbi ndryshimet me kalimin e kohës. Moshë ligjore për martesë është 18 vjeç si për burrat ashtu dhe gratë. Në 2011, rreth 2 për qind e burrave dhe 3 për qind e grave të moshës 17 dhe më të rinj ishin martuar tashmë (Grafiku 4). Afërsisht i njëjti numër – më shumë se 400 vajza dhe 400 djem – ose njerëz të moshës 15 vjeç ishin martuar. Megjithatë, shifrat e martesës midis 16 dhe 17 vjeçarëve tregojnë që, në përgjithësi, martesat e hershme janë më mbizotëruese tek gratë se sa burrat.

**Grafiku 4****RAPORTI I NJERËZVE TË MARTUAR PARA MOSHËS LIGJORE 18 VJEÇ, SIPAS SEKSIT, SHQIPËRI, 2011**


Burim: *Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

## Fertiliteti tek Adoleshentët

Fertiliteti tek adoleshentët – numri i grave të moshës 15-19 që kanë lindur të paktën një fëmijë – ndikimi te shëndeti, arsimi dhe rezultatet ekonomike për gratë e reja dhe familjet e tyre. Sipas raporteve mbi zhvillimin njerëzor në Shqipëri, norma e fertilitetit tek adoleshentët është 14.9 lindje për 1,000 gra të moshës 15-19.<sup>5</sup> Censusi 2011 sugjeron që, edhe pse e ulët, kjo normë mund të rritet, me 2.9 për qind të të rejave që kanë lindur të paktën një herë para moshës 20 vjeç. Normat e fertilitetit janë të ulëta midis vajzave të moshës 15-17 krahasuar me ato të moshës 18 dhe 19 (Grafiku 5).

**Grafiku 5**

### NORMAT E LINDJES SË ADOLESHENTËVE SIPAS MOSHËS, SHQIPËRI, 2011



Burim: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri


Duke krahasuar ndjekjen e shkollës së nënave adoleshente me atë të të gjitha grave të moshës 15-19, nuk është habi të shikosh që shumica e ka lënë shkollën (86%). Nënata adoleshente kanë më shumë gjasa të mos e kenë ndjekur kurrë shkollën (7%) se sa popullsia e femrave adoleshente në tërësi (2%). Këto pika të marrëdhënies midis arsimit dhe lindjes së hershme; si roli që sistemi arsimor luan në sigurimin e edukatës seksuale për burrat dhe gratë e reja, ashtu edhe rëndësia e krijimit të mundësive për nënat e reja për të vazhduar shkollën.

5 UNDP 2013. Zhvillimi Njerëzor 2013: Ngritja e Jugut – Zhvillimi Njerëzor në një Botë me Diversitet.

**Nënat e reja kanë pak gjasa të qëndrojnë në shkollë.**

**Grafiku 6**

**STATUSI ARSIMOR I GRAVE TË MOSHËS 15-19 KRHASUAR ME NËNAT E MOSHËS 15-19, SHQIPËRI, 2011**



*Burim: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

## Familjet dhe shtëpitë

Ka rreth 722,000 banesa në të gjithë Shqipërinë me më shumë se gjysmat prej tyre (57%) që gjenden në qendrat urbane. Numri mesatar i njerëzve për banesë është 3.9 në nivel kombëtar (3.6 në zonat urbane dhe 4.2 në ato rurale). Kjo përfaqëson një rënie të vogël të madhësisë së shtëpisë nga 4.2 në 2001, si dhe 0.6% më pak banesa se sa në 2001. Duke parë më prapa në 1979, banesat ishin më të mëdha, sidomos në zonat rurale, me një mesatare prej 4.6 dhe 6.2 respektivisht.<sup>6</sup> Më 2011, madhësia e banesave ishte më e madhja në Kukës me 5.0 persona mesatarisht dhe më e vogla në Gjirokastrë, me 3.4 njerëz për banesë.

Banesat mund të përmbajnë një bërthamë familjare, bërthama të shumëfishta familjare ose një kombinim të të afërmeve të tjerë ose jo të afërm. Shumica e banesave përmbajnë një familje, qoftë një çift me ose pa fëmijë, ose një prind të vetëm dhe fëmijë. Këtyre u referohet si një bërthamë familjare dhe më shumë se 80 për qind e banesave Shqiptare përbëhen në këtë mënyrë. Kini parasysh se banesat mund të përmbajnë edhe persona të tjerë, në shtesë të bërthamës familjare. Rreth 10 për qind e banesave përmbajnë dy ose më shumë bërthama familjare, dhe 8 për qind nuk përmbajnë bërthama familjare (p.sh. persona beqarë ose që ndajnë shtëpinë).

Në total, ka pothuajse 727,000 bërthama familjare në Shqipëri, ose duke jetuar individualisht ose në banesa të përbëra. Siç tregohet në Grafikon


6 MPCSSH dhe UN Women, 2012. Raporti Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave.

7, lloji më i zakonshëm i bërthamës familjare është një çift me fëmijë (67% e familjeve). Një çerek (25%) e familjeve janë çift pa fëmijë, edhe pse kjo përfshin çifte që synojnë të kenë fëmijë, por që nuk e kanë bërë ende. Raporti për secilin lloj të bërthamës familjare ka ndryshuar që nga censusi i fundit i popullsisë në 2011. Atëherë, çiftet me fëmijë përbënin 79% të familjave bërthamore, dhe çiftet pa fëmijë ishin më pak, tek 14% e familjeve. Rritja në raportin e çifteve pa fëmijë mund të tregojë që çiftet e reja kanë më shumë gjasa të jetojnë sëbashkur se sa në të kaluarën dhe po presin më gjatë para se të krijojnë një familje. Analiza të mëtejshme të të dhënave të lidhura me martesat, kushtet e jetesës dhe lindjeve do të siguronin më shumë informacion për këto prirje.

**Gratë dretojnë shumicën e familjeve me një prind.**

**Grafiku 7**

**LLOJI I FAMILJES BËRTHAMË, SHQIPËRI, 2011**



*Burim: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

Ekzistojnë më shumë se 60,000 familje me një prind, që përfaqësojnë rreth 8 për qind të të gjitha familjeve në Shqipëri, e rritur lehtë nga 7 për qind më 2001. Prindërit e vetëm mund të jenë të ndarë nga bashkëshorti në kohën e censurit, ose përkohësisht (p.sh. migrim për arsye ekonomike), ose përgjithmonë. Kjo përfshin prindër që janë ende të martuar, të ndarë, të divorcuar ose të ve.




Pjesa më e madhe e prindërve të vetëm janë gra (84%) dhe kjo është rritur që nga 2001 kur gratë përbënin 80 për qind të 42,000 të prindërve të vetëm. Shumica e familjeve me një prind kanë dy fëmijë (41%) dhe nuk ka dallime në madhësinë e familjes së babait apo nënës së vetme; të dyja kanë 2.7 persona, mesatarisht.

Siç tregon Grafiku 8 më poshtë, gjithashtu nuk ka një dallim shumë të madh në moshën e fëmijëve midis familjeve me baba të vetëm dhe nënë të vetme, thjesht një prirje të lehtë për nënat e vetme për të pasur fëmijë më të vegjël (të moshën 5-17 vjeç) në shtëpi se sa baballarët e vetëm. Megjithatë, ka një dallim të qartë midis familjeve me një prind të vetëm dhe atyre ku prindërit jetojnë ende bashkë. Çiftet kanë më shumë gjasa të vazhdojnë të jetojnë bashkë kur fëmijët e tyre janë nën 18 vjeç, kur ata janë më të varur. Një raport shumë më i vogël i çifteve ka ende fëmijë të moshës 25 vjeç e lart që jetojnë me ta, krahasuar me rastin e prindërve të vetëm.

**Familjet me prindër të vetëm janë më të përhapura ndërsa fëmijët rriten**

**Grafiku 8**

**RAPORTI I FAMILJEVE ME FËMIJË TË MOSHAVE TË NDRYSHME QË JETOJNË ME TA, SIPAS LLOJIT TË FAMILJES, SHQIPËRI, 2011**



Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri





**Shëndeti dhe Mirëqenia**



## Shëndeti dhe Mirëqenia

### Mesazhet kryesore:

- Censusi i popullsisë mbledh informacion të kufizuar në lidhje me shëndetin.
- Dinamikat e popullsisë, si plakja dhe migrimi në zonat urbane, do të ndikojnë në kërkesën për shërbime shëndetësore.
- Gratë kanë më shumë gjasa të kenë një aftësi të kufizuar se burrat. Ky hendek gjinor ndodh me shumë gjasa prej marrëdhënies midis aftësisë së kufizuar dhe vjetërsisë, dhe faktit që gratë priren të jetojnë më gjatë dhe përbëjnë shumicën e popullsisë së moshuar.
- Rreth 20% e fëmijëve me aftësi të kufizuar nuk e kanë ndjekur shkollën, krahasuar me 2% të fëmijëve 6-14 vjeç. Situata është disi më e rëndë për djemtë me aftësi të kufizuar.

Shëndeti i mirë është një përbërës thelbësor për cilësinë e jetës, harmoninë shoqërore dhe prosperitetin ekonomik. Informacioni i detajuar rreth problemeve dhe rezultateve shëndetësore, si lloji i gjendjes shëndetësore dhe sëmundjes, nuk mblidhen zakonisht nëpërmjet censusit të popullsisë dhe banesave. Ky informacion vjen nga regjistrat e mbajtura nga spitalet dhe shërbimet shëndetësore dhe anketat e veçanta për shëndetin. Megjithatë, ka një numër të rëndësishëm treguesish kur bëhet fjalë për rezultatet shëndetësore që janë të disponueshme nga censusi. Kjo përfshin shifrat e popullsisë që ilustrojnë varësinë dhe ndryshimet në kërkesën për shërbime shëndetësore, fertilitet, shtatëzani tek adoleshentët dhe mbizotërimin e llojeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

### Gjetjet kryesore

- Migrimi nga zonat rurale në urbane dhe një popullsi në plakje do të rrisë presionin për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.
- Janë afërsisht dy njerëz në moshë pune për çdo fëmijë/të moshuar në varësi.

- Mbizotërimi i aftësisë së kufizuar lidhet ngushtë me plakjen dhe është më e lartë ndër gratë.
- Vështirësitë në shikim dhe në ecje janë format më të zakonshme të aftësisë së kufizuar si për gratë ashtu dhe burrat.


## Kërkesat për shërbime shëndetësore

Raporti i varësisë krahason numrin e njerëzve në moshë pune (mosha 15-64) me ata që kanë gjasa të varen prej tyre për kujdes dhe mirëqenie, që do të thotë fëmijë (0-14 vjeç) dhe të moshuarit (mosa 65 e lart). Ky është një tregues i rëndësishëm për politikën dhe programet të lidhura me gjininë. Një nivel i lartë i varësisë përforcon stereotipet gjinore të burrave që sigurojnë bukën dhe të grave kujdestare dhe kufizon zgjedhjet e grave për të ndjekur mundësi që gjenerojnë të ardhura.

Teksa nevoja për kujdes shëndetësor është zakonisht më e madhe gjatë viteve të para dhe të fundit, raporti i varësisë ka ndërlkime të veçanta për sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe mund t'i bëjë politikëbërësit që të marrin parasysh kërkesat në ndryshim. Në Shqipëri, kishte 47 njerëz të varur për çdo 100 njerëz në moshë pune. Kjo është afërsisht dy njerëz në moshë pune për një fëmijë/të moshuar. Raporti i varësisë së Shqipërisë i afrohet mesatares botërore, e llogaritur tek 50.

Grafiku 9

### NORMA E VARËSISË SË FËMIJËS DHE TË MOSHUARIT SIPAS PREFEKTURËS, SHQIPËRI, 2011



Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

Siç mund ta shikoni në Grafikun 9, raporti i varësisë në Shqipëri është më e lartë në zonat rurale se sa urbane, tregues i faktit që fëmijët dhe të moshuarit kanë më shumë gjasa të mbeten në zonat rurale se sa të shpërngulen në qendrat urbane. Kjo tregon rëndësinë e sigurimit të shërbimeve të përshtatshme shëndetësore dhe arsimore në zonat rurale. Raporti i fëmijëve nën 15 është gjithashtu mjaft i lartë krahasuar me raportin e moshës 65 e lart. Varësia është më e lartë në Kukës, ku ka një popullsi relativisht të re në numrin e personave në moshë pune. Raporti është gjithashtu mbi mesataren kombëtare në Shkodër dhe Dibër.

Gratë dhe burrat kanë probleme të ndryshme shëndetësore dhe shpesh shfaqin qëndrime dhe sjellje të ndryshme ndaj të kërkuarit e kujdesit shëndetësor. Shërbimet dhe programet e shëndetit parandalues kanë nevojë të shënjestrojnë probleme të veçanta për gratë dhe burrat dhe të konsiderojnë se si normat e gjinisë ndikojnë në dhënien e shërbimit. Për shembull, mund të duhen programe të veçanta për shëndetin e burrave për t'i inkurajuar burrat të kërkojnë kujdes dhe të ulin rreziqet për shëndetin, siç janë pirja e duhanit dhe e alkoolit.

## Aftësia e kufizuar

Aftësitë e kufizuara kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë Shqiptare. Me përdorimin e ndihmave, mbështetjes dhe infrastrukturës së përshtatshme, njerëzit me aftësi të kufizuar mund të aksesojnë mundësitë për arsim, punësim dhe pavarësi. Censusi siguron të dhëna për raportin e njerëzve me një aftësi të kufizuar, vendndodhjen e tyre, moshën, seksin, statusin e punësimit dhe nivelin e arsimit. Bashkë, ky informacion është thelbësor për zhvillimin e politikave dhe programeve për të siguruar mundësi të barabarta dhe për t'u siguruar mbështetjen e përshtatshme.


Shikimi dhe të ecja janë format më të zakonshme të aftësisë së kufizuar ndërmjet grave dhe burrave. Përmes të gjitha llojeve të aftësisë së kufizuar, janë gratë ato që kanë më shumë gjasa të kenë vështirësi se burrat. Ky hendek gjinor vjen kryesisht si pasojë e lidhjes midis aftësisë së kufizuar dhe plakjes dhe prej faktit që gratë kanë prirje të jetojnë më gjatë dhe të përbëjnë shumicën e popullsisë së moshuar.

## Aftësia e kufizuar më e përhapur midis grave.


Grafiku 10

## MBIZOTËRIMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR PËR POPULLSINË E PËRGJITHSHME TË MOSHËS MBI 15, SIPAS LLOJIT DHE SEKSIT, SHQIPËRI, 2011

## Meshkujt e moshës 15 e lart



## Femrat e moshës 15 e lart



Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri


Siç ilustron Grafiku 10, aftësia e kufizuar e rëndë është e lidhur ngushtë me plakjen. Meqënëse ka më shumë gra se sa burra në grupmoshën më të moshuar, kjo i anon këto të dhëna drejt një raporti më të madh të grave me aftësi të kufizuar se sa burrat. Hendekët gjinorë në raportet e aftësisë së kufizuar të rëndë janë më të dukshme për lëvizjen dhe aftësitë e kufizuara të lidhura me kujdesin vetjak.



Aftësia e kufizuar e rëndë është e lidhur me plakjen.

Grafiku 11

**MBIZOTËRIMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR TË RËNDË, SIPAS LLOJIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR, SEKSI DHE GRUPMOSHA, SHQIPËRI, 2011**



Burimi: *Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

Aftësia e kufizuar, sidoqoftë, nuk mund të harrohet që është një problem për të moshuarit. Një krahasim i statusit të arsimit të deritanishëm midis fëmijëve në moshë shkollore me dhe pa aftësi të kufizuar tregon se ata me aftësi të kufizuar kanë më pak gjasa të ndjekin shkollën (Tabela 2). Rreth 20% e fëmijëve me aftësi të kufizuar s'e kanë ndjekur kurrë shkollën, krahasuar me 2% të popullsisë në tërësi të moshës 6-14. Situata është pak më keqe për djemtë me aftësi të kufizuar.

**Fëmijët me aftësi të kufizuar të rëndë kanë më shumë gjasa të mos e kenë ndjekur kurrë shkollën**

Tabela 2

**STATUSI ARSIMOR I FËMIJËVE ME NJË AFTËSI TË KUFIZUAR, SIPAS SEKSIT, SHQIPËRI, 2011**

	Të gjithë fëmijët meshkuj moshë 6-14		Fëmijët meshkuj me aftësi të kufizuar * moshë 6-14		Të gjithë fëmijët femra moshë 6-14		Fëmijët femra me aftësi të kufizuar * moshë 6-14	
	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%
Në shkollë	189,225	96	2,728	73	174,950	96	2,274	77
E kanë lënë shkollën	5,362	3	118	3	5,264	3	112	4
Kurrë nuk e kanë ndjekur shkollën	3,215	2	871	23	2,636	1	581	20
<b>Totali</b>	<b>197,802</b>	<b>100</b>	<b>3,717</b>	<b>100</b>	<b>182,850</b>	<b>100</b>	<b>2,967</b>	<b>100</b>

\* Fëmijët me aftësi të kufizuar janë ata që kanë shumë vështirësi ose janë plotësisht të paaftë për të bërë një ose më shumë ng fushat e aftësisë të matura në census.

*Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

**KUTIA 2**
**Si e mat censusi aftësinë e kufizuar?**

Në 2011, censusi përfshiu, për herë të parë, pyetje që lidhen me aftësinë e kufizuar. Ka pyetur nëse ndonjë anëtar i familjes ka ndonjë vështirësi në funksionet e mëposhtme:

1. shikimin; 2. dëgjimin; 3. ecjen ose ngjitjen e shkallëve; 4. kujtesën, përqendrimin apo marrjen e vendimeve; 5. Kujdesin vetjak të përditshëm; 6. Komunikimin.

Të anketuarit u pyetën për të treguar nëse kishin “asnjë vështirësi”; “disa vështirësi”; “shumë vështirësi”; ose “nuk mundeshin fare”. Kjo u përdor për të klasifikuar ashpërsinë e aftësisë së kufizuar. Ata që kanë shumë vështirësi ose nuk mund të bëjnë një funksion të caktuar, konsiderohen me aftësi të kufizuar të rëndë.





## Arsimi

### Mesazhet kryesore:

- Censusi dëshmon një etapë të rëndësishme të progresit në aksesin dhe rezultatet në arsimim.
- Sistemi arsimor duket sikur ka arritur shumicën e vajzave dhe të djemve, me një hendek gjinor jo të rëndësishëm në ndekje mes moshave 6 deri 17.
- Nivelet e ndjekjes së shkollës, arritjet në mësimi dhe edukimi kanë qenë të qëndrueshëm në dekadën e fundit.
- Nivelet më të ulëta të arsimimit të grave, në veçanti të grave në fshat, sugjerojnë që edukimi funksional dhe aftësitë numerike mund të jenë të varfëra dhe si rrjedhojë, edhe mundësitë e tyre për punësim dhe sipërmarrje janë më të kufizuara se për burrat.

Arsimi është kryesor për zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë. Duke nisur nga të mësuarit parashkollor deri tek ai për të rritur, arsimi formal ose jo-formal siguron njohuri dhe aftësi themelore që ndikojnë të gjitha aspektet e punës dhe jetës personale. Kyçe ndërmjet tyre janë aftësia për të lexuar dhe të shkruar, puna me numrat (numërimi) dhe aftësitë e nevojshme për të funksionuar në shoqërinë e përditshme.

### Gjetjet kryesore

- Ndjekja shkollës është e lartë ndër 6-14 vjeçarë dhe nuk ka ndonjë hendek gjinor të dukshëm.
- Djemtë po e lenë arsimin zyrtar që nga mosha 18 vjeç me norma më të shpejta se sa vajzat.
- Gratë e moshuara kanë më shumë gjasa të mos jenë arsimuar.
- Shumica e burrave dhe grave kanë mbaruar të paktën shkollën fillore; 85% e burrave dhe 80% e grave 15 vjeç e lart.

- Më pak se gjysma e popullsisë së Shqipërisë 18 vjeç e lart ka mbaruar arsimin e mesëm: rreth 41% e grave dhe 48% e burrave.
- Në 2011, numri mesatar i viteve që njerëzit kanë mbaruar shkollimin është 10, me asnjë ndryshim mes burrave dhe grave.
- Hendeku arsimor mes burrave dhe grave është më i dukshëm në zonat rurale, me më pak se një të katërtën (23%) e grave në zonat rurale që kanë mbaruar arsimin e mesëm, krahasuar me më shumë së gjysmën (56%) e grave në zonat urbane.
- Edukimi tek të rriturit mbetet i lart me një hendek gjinor të lehtë që konsiston; 96% e burrave dhe 94% e grave 15 vjeç e lart janë në gjendje të lexojnë dhe të shkruajnë në një ose më shumë gjuhë.

Sistemi arsimor kërkon që të gjithë banorët të përfundojnë arsimin bazë prej nëntë vjetësh, të përbërë nga pesë vjet shkollë fillore (Klasa 1-5) dhe katër vjet e mesme e ulët (Klasa 6-9). Kuadri ligjor garanton aksesin universal në arsim për vajzat dhe djemtë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) është e detyruar të sigurojë mundësi të barabarta.

### KUTIA 3

#### Çfarë mund të na thotë censusi për arsimin?

Censusi 2011 bëri katër pyetje mbi arsimin, duke siguruar të dhëna mbi edukimin, ndjekjen në arsimin formal, nivelin më të lartë të përfunduar dhe numrin e viteve të arsimit.<sup>7</sup> Ky informacion mund të ndahet në tabela sipas seksit, vendndodhjes gjeografike, llojit të punësimit, dhe shumë karakteristika të tjera individuale dhe të banesës.

### Ndjekja e shkollës

Sistemi arsimor duket se arrin shumicën e vajzave dhe djemve, me asnjë hendek gjinor të rëndësishëm në ndjekjen e shkollës midis moshave 6 deri 17. Të rinjtë fillojnë ta lënë shkollën që nga mosha 14, por ndjekja bie ndjeshëm nga mosha 18 (Grafiku 12). Në këtë pikë, janë burrat e rinj që kanë më shumë gjasa të jenë larguar se sa gratë e reja.

Të dhënat mbi diplomimin terciar gjithashtu reflektojnë këtë fakt, duke treguar që në 2008/9 dhe 2009/10, dy të tretat e të diplomuarve nga

<sup>7</sup> Informacioni mbi edukimin dhe ndjekjen u pyetet të gjithëve mbi moshën gjashtë, pyetjet mbi nivelin dhe vitet e përfundimit u bëhen të gjithëve mbi dhjetë vjeç.

universitetet publike ishin gra.<sup>8</sup> Prirja që gratë mbeten në arsimin formal mund të jetë një shenjë e diskriminimit në tregun e punës dhe mundësive të kufizuara. Nëse vajzat e reja kanë më pak shanse për t'u punësuar, ato vendosin që qëndrimi në studimet formale është zgjedhja më e mirë.

**Djemtë e rinj kanë më shumë gjasa ta lenë arsimin që nga moshja 18**

### Sistemi Arsimor Shqiptar

Sistemi arsimor në Shqipëri përbëhet nga 5 nivele të përgjithshme:

#### Arsimi parashkollor

(kopshti), jo i detyrueshëm, moshja 3-5

**Shkolla fillore**, e detyrueshme, moshja 6-10 (klasa 1-5)

**Shkolla e mesme e ulët**, e detyrueshme, moshja 11-14 (Klasa 6-9)


**Shkolla e mesme e lartë**, jo e detyrueshme, moshja 15-17 (klasa 10-12)

**Terciar**, jo i detyrueshëm, moshja 18 – 22 (pesë vjet pas sistemit të mesëm)

*Burimi: Të Dhënat Botërore mbi Arsimin UNESCO, botimi i 7-të, 2010/11.*

**Grafiku 12**

**POPULLSIA BANUESE E MOSHËS 6-24 QË PO NDJEKIN AKTUALISHT SHKOLLËN, SIPAS SEKSIT DHE MOSHËS (%) (NORMAT E NDJEKJES SPECIFIKUAR SIPAS MOSHËS), SHQIPËRI, 2011**



*Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

8 MPCSSHB dhe UN Women. 2012. Raporti Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave.

**KUTIA 4****Cili është ndryshimi midis ndjekjes neto dhe bruto dhe raportet e regjistrimit?**

Ndjekja dhe regjistrimi janë matje të ngjashme të pjesëmarrjes në sistemin arsimor. Megjithatë, meqënëse është e mundur të regjistrohesh por mos ta ndjekësh shkollën, dhe e anasjellta, ato masin gjëra të ndryshme dhe janë të dyja të rëndësishme për të kuptuar situatën. Censusi i popullsisë mat ndjekjen në arsim, ndërsa regjistrimi matet bazuar në regjistrat e shkollës të ruajtura në sistemin kombëtar arsimor.

Normat e ndjekjes/regjistrimit neto dhe bruto janë matjet standarte të pjesëmarrjes në arsim. **Normat neto** llogariten duke pjesëtuar numrin e fëmijëve zyrtarisht në moshë shkolle (p.sh.6-10 vjeç për shkollën fillore) që frekuentojnë shkollën fillore, me numrin total të fëmijëve në atë grupmoshë. Duke qenë se fëmijët mund të frekuentojnë një klasë më të ulët ose më të lartë (p.sh. një 6 vjeçar mund të jetë ende në parashkollor), këto norma nuk janë domosdoshmërisht një reflektim nëse të gjithë fëmijët janë në shkollë, por vetëm nëse janë në nivelin e duhur të shkollës të përshtatshme për moshën e tyre.

**Normat bruto** llogariten në mënyrë të ngjashme, përveç se është totali i popullsisë që frekuenton atë nivel shkollimi, pavarësisht moshës së tyre, i pjesëtuar me numrin total të fëmijëve në moshë zyrtare për atë nivel. Normat bruto janë zakonisht më të larta se sa normat neto, sidomos kur ka një numër të madh njerëzish mbi moshë ose nën moshë për atë nivel shkollimi

Të dhënat e publikuara nga INSTAT-i tregojnë një prirje në rënie të regjistrimeve bruto në shkollën fillore si për djemtë ashtu edhe vajzat. Në 2008/2009 normat ishin rreth 94 për qind për djemtë dhe 92 për qind për vajzat. Në vitin vijues (2009/10), regjistrimet bruto ranë disi me 92 për qind për djemtë dhe 90 për qind për vajzat. Megjithatë, këto shifra ishin bazuar në popullsinë e llogaritur nga censusi 2001, që mund ta ketë vështirësuar saktësinë e tyre.<sup>9</sup>

Është e mundur të prodhohen norma të ndjekjes neto dhe bruto për nivele të ndryshme shkollimi nga të dhënat e censurit (shikoni tabelën më poshtë për ndryshimet midis ndjekjes dhe regjistrimit). Rezultatet tregojnë që ndjekja është më e ulët se sa regjistrimi dhe për shkollën fillore, ka pak ndryshim midis djemve dhe vajzave, ose midis zonave urbane dhe rurale (Tabela 3). Hendekët fillojnë të dalin në shkollën e mesme, ku një numër i lartë i djemve po e ndjekin, dhe zonat urbane kanë norma ndjekjeje më të larta se sa ato rurale.

9 MPÇSSHB dhe UN Women. 2012. Raporti Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave.



**Tabela 3****NORMAT E NDEKJES NETO DHE BRUTO, SIPAS NIVELIT TË SHKOLLIMIT, SHQIPËRI, 2011**

	Totali (%)	Meshkuj (%)	Femra (%)	Urbane (%)	Rurale (%)
Norma neto e ndekjes së fillores (NNN)	79.8	80.1	79.4	79.6	79.9
Norma bruto e ndekjes së fillores (NBN)	83.9	84.0	83.8	83.2	84.6
E mesme e ulët NNN	69.1	69.5	68.6	71.0	67.2
E mesme e ulët NBN	91.5	92.3	90.6	93.9	89.1
E mesme e lartë NNN	64.2	64.5	63.8	69.6	58.8
E mesme e lartë NBN	101.9	104.6	99.2	107.5	96.4
Terciare NNN	33.4	28.3	38.8		
Terciare NBN	50.8	45.7	56.1		

*Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

Indeksi i barazisë gjinore (Grafiku 13) tregon që i njëjti raport i djemve dhe vajzave po ndjekin shkollën fillore. Për shkollën e mesme të ulët dhe sidomos atë të lartë, djemtë janë në avantazh të lehtë ndaj vajzave. Kjo sugjeron që nevojiten politika dhe programe për të mbajtur vajzat në shkollën e mesme të lartë, sidomos në zonat rurale. Në nivelin teriar, situata është e kundërt, me një frekuentim më të lartë nga vajzat se sa djemtë. Kjo prishje e ekuilibrit mund të tregojë një mungesë të mundësive për gratë në tregun e punës, se sa një diskriminim ndaj burrave në sistemin arsimor terciar.


Censusi nuk mbledh informacion mbi pjesëmarrjen në kurse profesionale jashtë atyre të ofruara në shkollat e mesme të ulëta profesionale. Burime të tjera tregojnë që kjo është një fushë e sunduar nga meshkujt, me dy të tretat (69%) e studentëve që janë meshkuj, dhe me shumicën e kurseve të fokusuar në zanate tradicionalisht për meshkuj, si mekanikë dhe ndërtim.<sup>10</sup> Prirja e të rinjve për të kërkuar një arsim profesional mund të shpjegojë mungesën e tyre relative nga institucionet terciare. Përfshirja në censusin tjetër të një pyetjeje më specifike për pjesëmarrjen në studime profesionale mund të sigurojë statistika të krahasueshme për një analizë gjinore më kuptimplotë.

10 MPÇSSH dhe UN Women. 2012. Raporti Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave.

### Barazia gjinore e arritur në ndjekjen e shkollës fillore

Grafiku 13

#### INDEKSI I BARAZISË GJINORE (IBGJ) SIPAS NIVELIT TË NDJEKJES SË SHKOLLËS, SHQIPËRI, 2011



Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

#### KUTIA 5

##### Çfarë është Indeksi i Barazisë Gjinore (IBGJ)

Indeksi i Barazisë Gjinore (IBGJ) krahason meshkujt dhe femrat bazuar tek norma bruto e frekuentimit (p.sh. numri i fëmijëve të çdo moshe që frekuentojnë shkollën fillore mbi numrin total të 6-10 vjeçarëve (p.sh. moshë zyrtare e shkollës fillore). Një IBGJ prej 1.0. tregon barazi gjinore – rezultati që synojnë zakonisht politikëbërësit. Më pak se 1.0. tregon mosbarazi në favor të meshkujve ( në mënyrë proporcionale më shumë meshkuj se sa femra ndjekin shkollën) dhe më i lartë se 1.0. tregon pabarazi në favor të femrave.


Ka pasur një përmirësim të gjerë në aksesin në arsim krahasuar me 50 vjet më parë, sidomos për vajzat. Censuri tregon që teksa hendeku është mbyllur për brezat e rinj, raporti i popullsisë që nuk ka qenë asnjëherë në shkollë është e lartë tek të moshuarat. Kjo reflekton faktin që gjatë rinisë

së tyre, mundësitë për gratë për të përfituar një arsim formal ishin të kufizuara. Mundësitë ishin gjithashtu të kufizuara për burrat, por në një shkallë më të ulët. Numri mesatar i viteve shkollore që banorët Shqiptarë përfundojnë ka rënë në 10 vjet, me asnjë ndryshim midis burrave dhe grave.<sup>11</sup> Ky është një përmirësim nga 8.6 vjet shkollë të raportuara në 2010-ën.<sup>12</sup>

**Gratë më të vjetra nuk e kanë ndjekur arsimin.**

**Grafiku 14**

**POPULLSIA BANUESE QË NUK E KA NDJEKUR KURRË SHKOLLËS, SIPAS SEKSIT DHE MOSHËS, (%), SHQIPËRI, 2011**



Burimi: *Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

## Arritjet në Arsim

Shumica e grave dhe burrat që kanë përfunduar studimet e tyre kanë përfunduar së paku shkollën e mesme të ulët. Siç tregon Grafiku 15, niveli mesatar i arsimit të përfunduar nga burrat dhe gratë zbulon se burrat po ruajnë një avantazh të lehtë në arsim. Përqindja e lartë e femrave me vetëm arsim fillor dhe të mesëm të ulët, dhe pjesa e madhe e burrave ndërmjet atyre me arsim të mesëm të lartë, të ilustron se, në përgjithësi, burrat po arsimohen më shumë së gratë.


11 INSTAT. 2012. Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat; Rezultatet Kryesore.

12 MPÇSSH dhe UN Women, 2012. Raporti Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Statusin e Grave.

### Burrat kanë një avantazh të lehtë arsimor.

**Grafiku 15**

**NIVELI MË I LARTË I ARSIMIT TË PËRFUNDUAR NGA NJERËZIT QË KANË NDJEKUR SHKOLLËN NË TË SHKUARËN, SIPAS SEKSIT, SHQIPËRI, 2011**



Burimi: *Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

Normat e përfundimit të shkollës fillore po tregojnë një statistikë për gjendjen e arsimit. Pjesa më e madhe e burrave dhe grave Shqiptare kanë përfunduar të paktën shkollën fillore: 83% e popullsisë së përgjithshme të moshës 15 ose më lart. Ka një ndryshim të vogël midis sekseve, me relativisht më shumë meshkuj që mbarojnë shkollën fillore (85%) se sa femrat (80%).

Të dhënat nga Banka Botërore të publikuara në raportin kombëtar për barazinë gjinore sugjerojnë se normat e përfundimit të fillores ishin afër 100 për qind në vitin 2004 (99% për burrat dhe 98% për gratë) dhe kishte rënë tek 88 dhe 89 për qind, përkatësisht, në vitin 2010. Rezultatet e censusit sugjerojnë një rënie të mëtjshme në 2011 në nivelet e raportuara më lart. Kjo mund të shpjegohet nga ndryshimet në mënyrën se si janë llogaritur normat e përfundimit, më shumë se një rënie e vërtetë në nivelet e arsimit. Megjithatë, kjo prirje është një shqetësim që meriton hetim të mëtjshëm.


Kur vjen puna për të përfunduar shkollën e mesme, më pak se gjysma

e popullsisë mbi moshën 18 e ka bërë këtë: rreth 41% e grave dhe 48% e burrave (Grafiku 16). Disavantazhi për femrat është më i rëndësishëm në zonat rurale, me më pak se një e katërta e grave në fshat (23%) që ka përfunduar shkollën e mesme, në krahasim me më shumë se gjysmën e grave në qytet (56%). Kjo nuk është domosdoshmërisht një reflektim i arsimit të varfër në zonat rurale, por më tepër tregues i prirjes së njërëzve të arsimuar më mirë për të lëvizuar në qendrat urbane, ku ekzistojnë mundësi më të mëdha punësimi. Megjithatë, familjet tradicionale në zonat rurale kanë prirje të mbajnë vajzat në shtëpi, sidomos kur zhvillohen fizikisht. Shumica e familjeve tradicionale rregullojnë martesat e hershme për vajzat, dhe prandaj ato braktistin shkollën.

**Pothuajse gjysma e banuesve Shqiptarë kanë përfunduar shkollën e mesme**

**Grafiku 16**

**NORMA E PËRFUNDIMIT TË SHKOLLËS SË MESME PËR POPULLSINË MBI 18, SIPAS SEKSIT DHE PREFEKTURËS, SHQIPËRI, 2011**



Burimi: *Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

Hendeku më i madh gjinor në përfundimin e shkollës së mesme ndodh në Kukës (hendek 14% ndërmjet burrave dhe grave) dhe Gjirokastrë (hendek 10%). Përfundimi i shkollës së mesme është më e ulët në mesin e të rriturve që jetojnë në Dibër (31% e ka përfunduar shkollën e mesme) dhe Elbasan (35%).

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2008, 12.4 për qind e popullsisë ka përfunduar arsimin terciar.<sup>13</sup> Censuri 2011 zbulon të njëjtin konstatim, me 12.3 për qind të banorëve Shqiptarë që mbajnë kualifikime terciare. Shkalla është pak më e lartë tek gratë - 12.6 për qind e grave mbajnë diplomë universitare ose doktoraturë, në krahasim me 12.1 për qind të burrave. Edhe pse gratë janë të mirë përfaqësuar edhe në mesin e atyre që marrin një arsim të lartë, të shkosh në përfundimin e studimit e terciare nuk është realiteti për shumicën e njerëzve. Në përgjithësi, burrat kanë ende më shumë gjasa se sa gratë për të përfunduar shkollën fillore dhe të mesme. Niveli më i ulët i arsimimit në mesin e grave, veçanërisht i atyre në zonat rurale, sugjeron që aftësitë në shkrim, lexim dhe në të numëruar mund të jetë të varfëra, dhe për këtë arsye, mundësitë e tyre për punësim dhe sipërmarrje ka të ngjarë të jetë më të kufizuara se sa të burrave.

## Edukimi

### E rëndësishme për t'u ditur

Nuk ka asnjë provë aktuale për aftësitë edukuese nëpërmjet censusit, por në vend të kësaj, leximi dhe shkrimi maten duke pyetur "A dini të lexoni dhe të shkruani?" Edukimi mund të jetë në çdo gjuhë, edhe pse bëhet gjithashtu një pyetje e veçantë për të gjetur gjuhën amtare të çdo personi. Prandaj të dhënat e censusit për normën e edukimit duhet të trajtohen me kujdes dhe nuk zbulojnë shkallën e edukimit funksional, që tregon nëse aftësitë gjuhësore janë të mjaftueshme për të funksionuar në shoqërinë e përditshme.

Edukimi – aftësia për të lexuar dhe shkruar në çdo gjuhë – mbetet i lartë në Shqipëri me afërsisht 100 për qind të popullsisë së përgjithme (Tabela 4). Ka një ndryshim jo të rëndësishëm të normave të edukimit tek të rinjtë midis burrave dhe grave, të dy janë rreth 99 për qind, duke ilustruar që hendeku gjinor në arsimin bazë është mbyllur.

13 MPÇSSHB dhe UN Women, 2012. Raporti Kombëtar mbi Barazinë Gjinore dhe Situatën e Grave.

Tabela 4

## NORMAT E EDUKIMIT TEK TË RINJTË DHE TË RRRITURIT, SIPAS SEKSIT, SHQIPËRI 2011


	Edukimi tek të rinjtë (mosha 15-24)			Edukimi tek të rriturit (mosha 15+)		
	Totali	Meshkuj	Femra	Totali	Meshkuj	Femra
Shqipëria	99.0	98.9	99.0	97.2	98.3	96.2
Urbane	98.9	98.9	98.9	97.9	98.6	97.1
Rurale	99.0	98.9	99.1	96.4	97.8	99.1

Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

Ka, megjithatë, dallime të mëdha gjinore në mesin e të moshuarve banues të Shqipërisë. Shumica e burrave të moshës 70 dhe lart dinë të shkruajnë dhe të lexojnë (89 %), në mënyrë të konsiderueshme më e lartë se norma e edukimit që shihet në mesin e grave të moshuara (66

Grafiku 17

## NORA E EDUKIMIT TEK TË RRRITURIT (MOSHA MBI 15) SIPAS SEKSIT DHE PREFEKTURËS, SHQIPËRI, 2011



Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

%). Siç mund të pritët, edukimi i të rriturve është më i lartë në mesin e banorëve të kryeqytetit, Tiranës, ku hendeku gjinor është edhe më i ulët (Grafiku 17). Një fushë e mundshme shqetësuese është shkalla më e ulët e shkollimit në prefekturat e Lezhës dhe Elbasanit. Është gjithashtu në ato prefektura, si dhe në Dibër, që hendeku gjinor është më i gjerë.

Krahasimi i pjesëmarrjes në tregun e punës me niveli arsimor tregon marrëdhënien e ngushtë midis punës dhe studimit.<sup>14</sup> Sa më shumë të arsimuar burrat dhe gratë janë, aq më shumë gjasa ka të jenë të punësuar. Kjo ilustron me ngushtimin e hendekut gjinor në normat e punësimit të burrave dhe grave teksa rritet niveli i arsimit.

Hendeku gjinor është shumë i hollë për ata që kanë një kualifikim terciar: rreth 69 për qind e burrave me kualifikim terciar janë të punësuar dhe rreth 62 për qind e grave. Anasjellas, pak njerëz me nivel të ulët arsimor (pa diplomë) janë të punësuar; rreth 12 për qind e burrave dhe më pak se 10 për qind e grave.

Normat e punësimit mes të arsimuarve pak janë ulur ndjeshëm nga censusi i 2011 kur më shumë se 40 për qind e burrave pa diplomë ishin të punësuar dhe rreth një çerek (25%) e grave. Kjo është një shenjë si e rritjes së nivelit arsimor në popullsi, ashtu edhe e kërkesave të tregut të punës për punonjës të arsimuar më mirë.<sup>15</sup>

Marrëdhënia midis studimit dhe punës tregohet gjithashtu në normat e papunësisë, të cilat janë ekstremisht të larta si për burrat ashtu edhe gratë që kanë pak arsimim (asnjë diplomë). Rreth 62 për qind e burrave të arsimuar pak janë të papunë dhe 67 për qind e grave. Papunësia mes atyre me shkollë të mesme është afërsisht 30 për qind si për burrat ashtu edhe gratë.<sup>16</sup> Kapitulli tjetër eksploron se çfarë rezultatet e censusit 2011 tregojnë rreth çështjeve gjinore në punë dhe punësim.

---

14 INSTAT, 2014. Dinamikat e Tregut të Punës në Shqipëri 2001-2011

15 INSTAT, 2014. Dinamikat e Tregut të Punës në Shqipëri 2001-2011

16 Si më sipër.





**Migrimi**



## Migrimi

### Mesazhet kryesore:

- Pirjet për migrim kanë ndryshuar, duke rritur rëndësinë e analizës së rregullt të statistikave të lidhura me të.
- Migrimi duhet të studiohet me lente gjinore për të siguruar një të kuptuar më të mirë për dimensionin gjinor dhe ndikimin e tij.
- Migrimi ndërkombëtar ishte kryesisht mashkullor në të kaluarën, por ky nuk është më rasti. Emigrimi femëror është rritur si pasojë e bashkimeve familjare dhe mundësive më të mira jashtë vendit.
- Më shumë se 20 vjet më parë, kishte një migrim të jashtëm masiv; tani emigrantët po kthehen në Shqipëri.
- Gratë kanë më shumë gjasa të emigrojnë së brendshmi se sa burrat, me shtysën kryesore atë të arsyejeve familjare.

Nivelet e larta të migrimit të brendshëm dhe ndërkombëtar në Shqipëri, veçanërisht në fillim të viteve 1990, e bëjnë këtë një faktor të rëndësishëm për vendin dhe një që ndikon në marrëdhëniet gjinore. Emigrimi dhe migrimi i brendshëm ka shërbyer si burim kryesor i të ardhurave përmes remitancave, në mënyrë të konsiderueshme duke kontribuar në ekonominë e vendit. Ndikimet, megjithatë, nuk janë të kufizuara vetëm në sigurimin e të ardhurave, por ata kanë shumë aspekte dhe dimensione.

### Gjetjet kryesore

- Arsyet familjare janë shtysa kryesore si për burrat dhe për gratë për të migruar brenda vendit.
- Arsyet për t'u kthyer nga jashtë vendit ndryshojnë ndërmjet burrave dhe grave. Burrat kthehen kryesisht pasi mbarojnë punën jashtë vendit; midis grave është kryesisht për arsye familjare.


- Më shumë burra Shqiptarë kanë jetuar jashtë vendit për një vit ose më shumë, se sa gratë Shqiptare.
- Greqia dhe Italia vazhdojnë të mbeten dy destinacionet për vendbanim jashtë vendit si për burrat ashtu dhe për gratë.
- Prirja e kthimit të emigrantëve në Shqipëri ka qenë në rritje për të dyja sekset, edhe pse meshkujt përbëjnë shumicën e emigrantëve të kthyer që nga Janari 2001.
- Një pjesë e vogël e rezidentëve Shqiptarë kanë imigruar në Shqipëri nga shtetet e tjera, kryesisht nga Greqia dhe Italia.
- Me përjashtimin e atyre që kanë lindur në Turqi, burra dhe gra të lindur jashtë vendit që vijnë të jetojnë në Shqipëri, e bëjnë për arsye familjare. Në rastin e Turqisë ka një dallim gjinor, me burrat që vijnë në Shqipëri për mundësi punësimi dhe gratë për arsye familjare.

Sipas censusit 2011, shtyja kryesore për migrimin e brendshëm si për burrat dhe për gratë është arsye familjare. Numri i femrave (103,260) që kanë migruar së brendshmi për arsye familjare është pothuajse dyfish krahasuar me meshkujt (59,189). Për burrat, arsyeja e dytë më e zakonshme për migrimin e brendshëm është punësimi, ndërsa për gratë, është për studim. Kjo mund të tregojë nivele të ndryshme të mundësive në tregun e punës për meshkujt dhe femrave dhe është një gjetje e rëndësishme për politikëbërësit. Për shembull, mund të jetë e mundur që gratë shkojnë më tej në studime si rezultat i mundësive të pakta të ofruara në tregun e punës.

Burrat në zonat urbane dhe rurale raportuan arsyet familjare dhe punësimin si dy arsyet kryesore për migrim të brendshëm, të ndjekur nga studimet. Mirëpo, arsyet për migrim të brendshëm ndryshojnë midis femrave urbane dhe rurale. Shumica e femrave urbane migrojnë së brendshmi për arsye familjare dhe studim, ndjekur nga punësimi. Femrat rurale migrojnë së brendshmi për arsye familjare, më pas punësim, ndjekur nga studimi.

Grafiku 18

## ARSYET PËR MIGRIM TË BRENDSHËM, SIPAS ZONËS DHE SEKSIT, SHQIPËRI, 2011



Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

Arsyet e kthimit nga jashtë vendit ndryshojnë midis burrave dhe grave në Shqipëri. Burrat kthehen në Shqipëri kryesisht pasi kanë mbaruar punën jashtë, e ndjekur nga arsyet familjare dhe mundësitë e punësimit. Gratë janë kthyer kryesisht për arsye familjare, e ndjekur nga mbarimi i punës jashtë dhe mundësitë e punësimit.


Meshkujt e kthyer për mundësi punësimi në Shqipëri janë pothuajse tre herë më shumë se femrat. Studimet e mbaruara dhe mundësitë e studimit në Shqipëri vijnë të fundit për të dyja seksat.

I njëjti grupim arsyesh për kthimin nga jashtë vendit është gjetur tek meshkujt dhe femrat urbane dhe rurale. Raporti i femrave rurale me femrat urbane (0.4) i kthimit nga jashtë vendit për mundësi punësimi në Shqipëri është më i vogël se raporti i meshkujve ruralë me ato urbanë

(0.7). Kjo gjetje sinjalizon një paralajmërim për hetime në të ardhme të kushteve të tregut të punës në termat e akomodimit të emigrantëve të kthyer dhe të mundësive që ofron për meshkujt dhe femrat.

Grafiku 19

## ARSYET PËR TË MIGRUAR NË SHQIPËRI NGA JASHTË SIPAS ZONËS DHE SEKSIT



Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

Arsyeja kryesore pse Shqiptarët kthehen për të jetuar në Shqipëri është se e kanë mbaruar punën jashtë vendit. Numri i femrave që kthehen për arsye familjare është më i madh se i burrave, që mund të tregojë për

rolin e femrave si kujdestare në shtëpitë shqiptare. Numri i burrave që kthehen për mundësi punësimi është më i madh se sa i femrave. Edhe një herë, dallimet në arsyet e kthimit për të jetuar në Shqipëri tregojnë që ndryshimet në tregun e punës ose janë të perceptuara ose janë të vërteta. Me përjashtimin e Turqisë, për të gjithë burrat dhe gratë e lindur në një vend tjetër dhe që vijnë të jetojnë në Shqipëri, arsyeja kryesore është familja. Në rastin e Turqisë, burrat vijnë të jetojnë në Shqipëri për mundësi punësimi, ndërsa gratë kryesisht vijnë për arsye familjare.

Tabela 5

**ARSYET E ARDHJES PËR TË JETUAR NË SHQIPËRI, SIPAS VENDLINDJES DHE SEKSIT, 2011**

Meshkuj						
Vendlindja	Mundësi Punësimi	Mbarimi i Punës Jashtë	Mundësi Studimi në Shqipëri	Mbarimi i Studimeve Jashtë	Arsye Familjare	Arsye të tjera
Shqipëri	12,411	28,918	1,737	2,384	12,038	32,467
Itali	76	16	21	-	1,157	213
Greqi	72	56	117	7	3,429	911
SHBA	33	23	4	-	192	58
Kanada	37	12	2	-	34	22
Turqi	210	32	13	3	75	82
Të tjera	258	24	246	11	513	275

Femra						
Vendlindja	Mundësi Punësimi	Mbarimi i Punës Jashtë	Mundësi Studimi në Shqipëri	Mbarimi i Studimeve Jashtë	Arsye Familjare	Arsye të tjera
Shqipëri	4,210	6,672	1,026	1,598	6,313	18,138
Itali	26	10	15	2	1,173	222
Greqi	43	43	122	4	3,309	863
SHBA	25	1	2	-	142	37
Kanada	5	-	-	-	26	12
Turqi	57	3	10	1	79	89
Të tjera	110	23	141	7	553	545


Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

Më shumë burra shqiptarë kanë jetuar jashtë vendit për një vit ose më shumë se sa gratë shqiptare. Greqia dhe Italia vazhdojnë të mbeten dy destinacionet kryesore për të banuar jashtë vendit. Afërsia, ngjashmëritë në kulturë dhe në mënyrën e të jetuarit, si dhe formimi i rrjetit të emigrantëve, vazhdojnë të mbajnë Greqinë dhe Italinë si dy shtetet kryesore të zgjedhura për të banuar jashtë vendit.

Numri i burrave që banojnë në Greqi dhe Itali është rreth dyfish më i lartë se i grave. Ndryshimet midis meshkujve dhe femrave pothuajse zhduken për në SHBA dhe Kanada (më shumë femra se meshkuj). Numri i njerëzve që banojnë në këto dy shtete është ekstremisht i ulët krahasuar me Greqinë dhe Italinë. Përveç numri të ulët të njerëzve që kanë jetuar jashtë vendit për një vit ose më shumë në SHBA dhe Kanada, ndryshimi i vogël mund të jetë si rezultat i përzgjedhjes së aftësive në këto dy shtete, ku njerëzit më të arsimuar/afësuar kanë prirje të shkojnë.

**Grafiku 20**

**BANUES JASHTË VENDIT, SIPAS KOMBËSISË, SEKSIT DHE VENDIT TË BANIMIT TË ZAKONSHËM (NUMRI QË KA JETUAR JASHTË VENDIT PËR NJË VIT OSE MË SHUMË), SHQIPËRI, 2011**



Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri



Gjithashtu, sistemi i lotarisë amerikane dhe kanadeze për migrimin mund të ndihmojë në mbajtjen e një ekuilibri gjinor dhe familjar. Numri i njerëzve që kanë jetuar jashtë vendit për një vit ose më shumë është më i madh mes atyre që jetojnë në zonat urbane se në ato rurale. Kjo është e vërtetë për të dyja sekset. Në rastin e Greqisë, burrat ruralë i tejkalojnë në numër burrat urbanë. Meshkujt përbëjnë shumicën e emigrantëve të kthyer që nga janari 2011. Prirjet e kthimit kanë qenë në ulje për të dy sekset, me një kulmim të kthimeve në 2011 për burrat dhe 2010 për gratë. Duke filluar nga 2008, tre vitet e fundit shënojnë numrin më të lartë të emigrantëve të kthyer për të dy sekset. Grupmosha me kthimet më të larta për të dy grupet është mosha midis 30 dhe 34 vjeç.

Ndërsa ka pasur fakte për migrim të jashtëm të femrave në vitet e fundit, të dhënat e censusit 2011 tregojnë që meshkujt janë kthyer nga migrimi në vitet e fundit. Kthimi nga migrimi është i rëndësishëm për formimin e aftësive, pasi emigrantët e kthyer kanë marrë aftësi të ndryshme nëpërmjet përvojave në vendet pritëse. Këto aftësi mund të jenë të dobishme kur ata kthehen në shtëpi në termat e punës si dhe nismave

Tabela 6

### QYTETARË SHQIPTARË BANUES JASHTË VENDIT QË JANË KTHYER PAS 1 JANARIT 2001 SIPAS SEKSIT, GRUPMOSHËS, DHE VITIT TË KTHIMIT, SHQIPËRI, 2011

Gjinia dhe grupmosha Sex and age group	Gjithsej Total	Viti i kthimit Year of returning										
		2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Gjithsej Total	43 815	1 605	2 378	2 781	2 720	3 004	2 612	2 544	3 251	5 372	8 351	9 197
Nën 10 vjeç Under 10 years	4 849	-	43	118	194	247	220	262	394	773	1 360	1 238
10-14	2 913	169	284	312	247	271	202	154	186	238	395	455
15-19	2 278	130	166	190	154	158	125	119	140	237	355	504
20-24	3 436	75	96	137	130	133	112	154	264	476	924	935
25-29	5 209	83	133	186	214	235	318	348	470	789	1 172	1 261
30-34	5 455	211	320	434	425	455	414	353	398	688	837	920
35-39	4 045	255	343	385	330	357	291	258	275	395	589	567
40-44	2 855	198	262	263	233	250	180	167	178	262	384	478
45-49	2 178	108	157	166	155	157	127	108	144	221	401	434
50-54	2 278	80	131	131	133	141	124	113	176	276	462	511
55-59	2 251	88	117	120	117	149	125	130	157	293	417	538
60-64	2 293	80	109	112	161	172	141	121	157	290	425	525
65+	3 775	128	217	227	227	279	233	257	312	434	630	831

Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

sipërmarrëse. Emigrantët e kthyer mund të sjellin gjithashtu burime financiare, si kursime, të cilat kontribuojnë në ekonominë shqiptare. Në anën tjetër, normat e larta të kthimit të emigrantëve duhet të integrohen në mënyrë efektive në tregun e punës në mënyrë që të shmangen nivelet e larta të nën dhe pa punësimit.

Tabela 7

### QYTETARË SHQIPTARË BANUES JASHTË VENDIT QË JANË KTHYER PAS 1 JANARIT 2001 SIPAS SEKSIT, GRUPMOSHËS, DHE VITIT TË KTHIMIT, SHQIPËRI, 2011

Gjinia dhe grupmosha Sex and age group	Gjithsej Total	Viti i kthimit Year of returning										
		2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
<b>Gjithsej Total</b>	<b>139 827</b>	<b>5 058</b>	<b>7 267</b>	<b>8 161</b>	<b>8 228</b>	<b>9 376</b>	<b>8 350</b>	<b>8 584</b>	<b>11 572</b>	<b>18 775</b>	<b>27 150</b>	<b>27 306</b>
Nen 10 vjeç Under 10 years	9 902	-	101	261	377	481	471	567	772	1 557	2 709	2 606
10-14	6 070	326	560	649	524	567	443	329	357	554	804	957
15-19	5 384	255	359	381	326	358	265	240	322	570	982	1 326
20-24	12 282	191	226	328	300	362	377	546	1 081	2 197	3 488	3 186
25-29	19 690	278	450	606	703	926	1 108	1 354	2 061	3 409	4 595	4 200
30-34	20 989	692	1 043	1 248	1 402	1 621	1 473	1 517	1 836	2 907	3 752	3 498
35-39	17 744	950	1 265	1 430	1 412	1 491	1 189	1 167	1 464	2 007	2 759	2 610
40-44	12 973	813	1 063	1 058	993	1 089	854	803	993	1 428	1 894	1 985
45-49	8 995	499	677	665	622	655	582	500	696	992	1 538	1 569
50-54	7 455	355	481	479	462	525	451	430	591	899	1 385	1 397
55-59	5 689	238	334	346	320	383	339	348	435	714	1 032	1 200
60-64	4 702	201	246	239	309	337	294	263	330	608	866	1 009
65+	7 952	260	462	471	478	581	504	520	634	933	1 346	1 763
<b>Gjithsej Total</b>	<b>96 012</b>	<b>3 453</b>	<b>4 889</b>	<b>5 380</b>	<b>5 508</b>	<b>6 372</b>	<b>5 738</b>	<b>6 040</b>	<b>8 321</b>	<b>13 403</b>	<b>18 799</b>	<b>18 109</b>
Nen 10 vjeç Under 10 years	5 053	-	58	143	183	234	251	305	378	784	1 349	1 368
10-14	3 157	157	276	337	277	296	241	175	171	316	409	502
15-19	3 106	125	193	191	172	200	140	121	182	333	627	822
20-24	8 846	116	130	191	170	229	265	392	817	1 721	2 564	2 251
25-29	14 481	195	317	420	489	691	790	1 006	1 591	2 620	3 423	2 939
30-34	15 534	481	723	814	977	1 166	1 059	1 164	1 438	2 219	2 915	2 578
35-39	13 699	695	922	1 045	1 082	1 134	898	909	1 189	1 612	2 170	2 043
40-44	10 118	615	801	795	760	839	674	636	815	1 166	1 510	1 507
45-49	6 817	391	520	499	467	498	455	392	552	771	1 137	1 135
50-54	5 177	275	350	348	329	384	327	317	415	623	923	886
55-59	3 438	150	217	226	203	234	214	218	278	421	615	662
60-64	2 409	121	137	127	148	165	153	142	173	318	441	484
65+	4 177	132	245	244	251	302	271	263	322	499	716	932

Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri



Puna dhe Punësimi



## Puna dhe Punësimi

### Mesazhet kryesore:

- Gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së vendit por vetëm një të tretën në punësim.
- Edhe pse Shqipëria ka parë një rritje ekonomike në vitet e fundit, pozita e grave në tregun e punës vazhdon të mbetet mbrapa me atë të grave në shtetet e Bashkimit Europian (BE).
- Gratë janë të përqendruara në sektorë dhe profesione që ofrojnë rroga të ulëta krahasuar me sektorë të mbizotëruar nga burrat.
- Varësia ekonomike ndaj të tjerëve mund të rrisë cënueshmërinë e grave, e cila si rrjedhojë mund të ndikojë në mirëqenien ekonomike të fëmijëve të tyre.
- Gratë janë të nënpërfaqësuar midis ligjvënësve, zyrtarëve të lartë dhe menaxherëve dhe si rrjedhojë kanë mundësi të kufizuara për t'u përfshirë drejtpërdrejt në vendimmarrje.
- Anketat e fuqisë punëtore bëhen vazhdimisht në Shqipëri dhe sigurojnë një matje më të saktë të aktivitetit ekonomik se sa censusi i popullsisë.

Statistikat e tregut të punës sigurojnë një vështrim mbi pozicionin e burrave dhe të grave në tregun e punës. Kjo është e rëndësishme për jetesën e individëve dhe të familjeve të tyre si dhe për rritjen ekonomike dhe produktivitetin e ekonomisë së një vendi.

Ka pasur një analizë të detajuar të të dhënave të censurit për fuqinë punëtore, të cilat përfshijnë krahasime të rezultateve të anketës së fuqisë punëtore. Këtyre publikime të vlefshme të botuara nga INSTAT në fillim të 2014 duhet t'u referohesh për më shumë informacion mbi dinamikat e fuqisë punëtore dhe karakteristikat ekonomike të popullsisë.<sup>17</sup> Kjo monografi gjinore synon të prezantojnë informacionin e duhur për të kuptuar ndikimin e gjinisë në punë dhe punësim.

17 INSTAT, 2014. Census 2011 i Popullsisë dhe Banesave: Karakteristikat Ekonomike; INSTAT, 2014. Dinamikat e Fuqisë Punëtore në Shqipëri 2001-2011.

### Gjetjet kryesore:

- Më pak gra marrin pjesë në fuqinë punëtore; 60.8% e grave krahasuar me 76.4% e burrave (Anketa e Fuqisë Punëtore 2011).
- Pjesëmarrja në fuqinë punëtore është rritur lehtë që në 2007 kur 56.2% e grave dhe 74.4% e burrave ishin në fuqinë punëtore (Anketa e Fuqisë Punëtore 2011)
- Censusi 2011 për popullsinë tregon nivel shumë më të ulët të aktivitetit ekonomik me 37.1% të grave dhe 62.4% të burrave në fuqinë punëtore. Megjithatë, metodologji të ndryshme të përdorura në census krahasuar me anketat e fuqisë treguan që disa lloje pune nuk ishin llogaritur.
- Gratë kanë prirje të jenë të përqendruara në një lloj të caktuar pune. Burrat kanë më shume gjasa të jenë punëdhënës ose të vetë-punësuar dhe gratë kanë gjasa të jenë të punësuar ose të kryejnë punë të papaguar në një biznes familjar.
- Arsyet e dhëna për të mos qenë në fuqinë punëtore (p.sh. i punësuar ose i papunë) ndryshojnë gjerësisht ndërmjet grave dhe burrave. Për gratë është kryesisht sepse janë shtëpiake me kohë të plotë (49%), por për burrat është sepse janë studentë (32%) ose sepse besojnë që nuk ka punë të disponueshme (28%).
- Gratë që nuk kanë fëmijë kanë shkallë më të lartë të aktivitetit ekonomik. Ndërsa numëri i fëmijëve rritet, aktiviteti ekonomik zakonisht bie, sidomos për gratë me katër ose më shumë fëmijë.
- “Profesionistët” është grupimi më i madh i profesioneve që mbizotërohet nga gratë (61% janë gra).
- Profesionet e mbizotëruara nga meshkujt janë zejtaria dhe tregtia e lidhur me të, operatorë dhe montues në fabrika dhe të makinerive, dhe forcat e armatosura.
- Gratë e punësuar janë kryesisht të përqendruara në sektorin e shërbimeve (kundrejt bujqësisë dhe industrisë) ku ato mbajnë 42% të këtyre punëve.
- Burrat punojnë me orar më të zgjatur në punë karshi grave, me pothuajse gjysmën e tyre (45%) që punojnë 40 orë ose më shumë në javë. Gratë raportojnë orar të ngjashëm, por kanë më shumë gjasa ta mbajnë orarin e punës në 36-40 orë në javë

### E rëndësishme për t'u ditur

Ka disa lloje punësh, të paguara dhe të papaguara. Punësimi nuk i referohet vetëm punëve të paguara por edhe vetë-punësimit në ekonominë informale, punës së papaguar në familjen bujqësore ose biznes, punën për të siguruar të mira, si ushqim për vetëpërdorim.

Censusi i popullsisë mbledh informacion nga të gjithë të moshës 15 e lart nëse ata punojnë, dhe nëse po, çfarë lloj pune bëjnë. Me këtë informacion popullsia mund të klasifikohet në tre kategori njëlloj eskuzive: Të punësuar, të papunë ose ata jashtë fuqisë punëtore (pasivë ekonomikisht). Fuqia punëtore e mundshme janë ata njerëz që janë ose të punësuar ose të papunë.

Censusi siguron të dhëna të rëndësishme mbi punën të krahasuar midis individëve të ndryshëm dhe karakteristikave të familjes, por në Shqipëri, ashtu si dhe në shtetet Europiane, të dhënat që rrjedhin nga censusi i popullsisë nuk përdoren si të dhënat zyrtare për normat punësimin dhe të papunësisë. Anketat e fuqisë punëtore, të cilat kryhen vazhdimisht në Shqipëri, sigurojnë një pikturë më realiste të pjesëmarrjes në format e ndryshme të punësimit. Për më tepër, për shkak të metodologjive të përdorura, prodhimi për përdorim vetjak në bujqësi dhe punësimi informal ishte nën llogaritur gjatë censurit të 2011 dhe normat rezultuese të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore janë të ndryshme nga anketa më e fundit për fuqinë punëtore. Për këtë arsye, informacioni për fuqinë punëtore bazuar në të dhëna të tjera të botuara nga INSTAT, prezantohet gjithashtu.


### Pjesëmarrja në fuqinë punëtore

Gratë kanë më pak gjasa se sa burrat të marrin pjesë në fuqinë punëtore. Rezultatet nga anketat shqipëtare për fuqinë punëtore tregojnë normat të qëndrueshme si për burrat ashtu edhe për gratë gjatë 5 viteve të fundit (Grafiku 21). Ka pasur një ngritje të dukshme në 2011, sidomos për gratë, me pjesëmarrjen në fuqinë punëtore që shkoi në 60.8% krahasur me 76.4% për burrat.

Duke marrë parasysh rolin e grave si kujdestare, shumë prej tyre janë jashtë fuqisë punëtore për shkak të përgjegjësive shtëpiake dhe familjare. Varësia ekonomike nga ana tjetër mund të rrisë cënueshmërinë e grave, e cila në këmbim mund të ketë ndikime në mirëqenien ekonomike të fëmijëve të tyre. Pjesëmarrja e ulët e grave në fuqinë punëtore gjithashtu ndalon rritjen e përgjithshme ekonomike dhe produktivitetin e ekonomisë së vendit.

Grafiku 21

## NORMAT E PJESËMARRJES NË FUQINË PUNËTORE, SIPAS SEKSIT, SHQIPËRI, 2007-2011




Burimi: Anketa e Fuqisë Punëtore (INSTAT, 2014. Dinamikat e tregut të punës 2001-2011)

Censusi tregon që dallimet në pjesëmarrjen në punësim janë më të mëdha midis burrave dhe grave në zonat rurale krahasuar me ata në zonat urbane. Ndër ata të punësuar në zonat urbane gratë mbajnë vetëm një pjesë cent 40 për qind. Në zonat rurale, hendeku gjinor është më i madh me gratë që përbëjnë 30 për qind të të punësuarve. Këto dallime mund të jetë për shkak të roleve të ndryshme gjinore midis zonave urbane dhe rurale, si dhe mungesës së mundësive për gratë rurale. Megjithatë, siç u përmend më sipër, censusi nuk llogariti pjesëmarrjen në punësimin për mbijetesë dhe bujqësinë informale, e cila mund të jetë një mënyrë për të shpjeguar këtë ndryshim.

Ata që nuk marrin pjesë në fuqinë punëtore, mund të jenë duke studiuar, në pension ose shtëpiakë me kohë të plotë. Arsyet e dhëna për të mos qenë të punësuar ose të papunë ndryshojnë gjerësisht nga gratë dhe burrat. Shumica e grave (49%) jashtë fuqisë punëtore janë të zëna si shtëpiake, duke pohuar se roli i gruas si kujdestare mbetet i rëndësishëm për shumë familje. Arsyja më e zakonshme e dhënë nga burrat për mos pjesëmarrje në fuqinë punëtore ishte të qenit student (32% e burrave pasivë), ndjekur nga afër nga besimi se nuk ka punë në dispozicion (28%).



**Grafiku 22****ARSYET PËR PASIVITET EKONOMIK, SIPAS SEKSIT, SHQIPËRI 2011**

Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

### Llojet e punësimit


Shumica e grave në punësim (61%) janë të punësuar, që do të thotë se bëjnë punë të paguar për një punëdhënës privat ose publik dhe marrin një lloj shpërblimi, si rrogë, ose pagesë në natyrë. Gratë kanë më pak gjasa se burrat të jenë punëdhënës ose të punojnë për vete (të vetëpunësuar). Dallimet e mëdha sipas llojeve të punës në termat e punëdhënësit ose punonjësve për vete (të vetëpunësuar) janë tregues i rolit dhe aktivitetit të ulët sipërmarrës të grave; një tjetër aspekt që kufizon pozicionin e grave në tregun e punës. Gratë janë gjithashtu më mirë të përfaqësuar ndër punëtorët kontribues në familje.

### Kufizimet në fuqinë punëtore

Amësia duket se luan një rol në shkallën e aktivitetit ekonomik të grave. Në përgjithësi, gratë pa fëmijë kanë shkallë më të lartë të aktivitetit ekonomik në krahasim me të gjitha gratë (Grafiku 24). Me rritjen e numrit të fëmijëve, aktiviteti ekonomik në përgjithësi bie, sidomos për gratë me katër ose më shumë fëmijë. Kjo tregon se roli i grave si nëna dhe kujdestare kryesore mund t'i largojë ato nga tregu i punës, veçanërisht në rrethana kur ka një mungesë kujdesi për fëmijët dhe mbështetje sociale.

Grafiku 23

## LLOJET E PUNËSIMIT, SIPAS SEKSIT, SHQIPËRI, CENSUSI 2011




Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

**Gratë me familje të madhe kanë më pak gjasa të marrin pjesë në fuqinë punëtore**

Grafiku 24<sup>18</sup>

## NORMAT E PJESËMARRJES SË GRAVE NË FUQINË PUNËTORE, SIPAS NUMRIT TË FËMIJËVE DHE MOSHËS



Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri

18 Numri i fëmijëve bazohet në fëmijët e lindur të gjallë.

Siç theksohet në kapitullin e arsimit, arsimi është një përcaktues i rëndësishëm i rezultateve të tregut të punës për individët. Niveli i arsimit është i lidhur fort me pjesëmarrjen në fuqinë punëtore, punësimin, zgjedhjet në punë dhe pagat. Arsimi është edhe më e rëndësishëm për femrat, të cilat përballen me kufizime shtesë në tregun e punës. Si pasojë, për nivel të ulët të arsimit, gratë kanë një normë shumë më të ulët të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore se burrat.

Sipas censusit, normat e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për ata që kurrë nuk kanë ndjekur shkollën është 32 për qind për burrat dhe 18 për qind për gratë. Në mënyrë të ngjashme, nga ata pa një diplomë, pjesëmarrja e fuqisë punëtore është 47 për qind për burrat dhe 25 për qind në mesin e grave. Me rritjen e arsimit, pjesëmarrja në fuqinë punëtore e grave rritet në një normë më të lartë se rritja për burrat. Në nivelin më të lartë të arsimit, gratë me doktoratura kanë mbi 93 për qind pjesëmarrje në fuqinë punëtore. Roli i arsimit, ndërsa ka gjasa të jetë i mjaftueshëm për të kapërcyer të gjitha pengesat për gratë për të marrë një punë të denjë, është në mënyrë të qartë im rëndësishëm

**Tabela 8**

**POPULLSIA EKONOMIKISHT AKTIVE, SIPAS NIVELIT ARSIMOR TË ARRITUR DHE SEKSIT**

Niveli arsimor	Norma e Pjesëmarrjes		
	Mashkull	Femër	Totali
Pa diplomë	47.0%	24.7%	35.5%
Fillore	45.9%	15.7%	28.8%
I mesëm i ulët	57.2%	27.4%	41.6%
I mesëm i ulët profesional	68.7%	37.0%	59.3%
I mesëm i lartë	64.8%	38.7%	52.6%
I mesëm i lartë teknik	73.5%	50.6%	64.0%
Terciar (BA)	62.0%	57.4%	59.4%
Terciar (BA/MA)	74.8%	71.9%	73.1%
Terciar (sistemi i vjetër)	84.5%	80.9%	82.7%
Pas-diplomimit / Master	84.7%	83.2%	83.9%
Doktoraturë / PhD	95.3%	93.8%	94.7%
Nuk e kanë ndjekur kurrë shkollën	31.9%	17.5%	24.8%

*Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

## Ndarja në profesion dhe industri

Ekzistojnë dallime të dukshme midis llojeve të profesioneve që gratë janë të punësuara, dhe gjendja ndryshon në mënyrë të konsiderueshme mes zonave urbane dhe rurale (Tabela 9). Gratë janë të nënpërfaqësura në mesin e ligjvënësve, zyrtarëve të lartë dhe menaxherëve, dhe po për këtë arsye kanë mundësi të kufizuara për t'u përfshirë drejtpërdrejt në vendimmarrje. Në zonat urbane, dallimet nga profesioni tregojnë se gratë mbajnë 25 për qind të vendeve të ligjvënësve, zyrtarëve të lartë dhe pozicionet menaxheriale; në zonat rurale është shumë më pak (15% gra). Shumica e profesionistëve në zonat urbane janë gra (62%), si dhe në zonat rurale (57%). Profesionet e dominuara nga meshkujt përfshijnë forcat e armatosura (90% meshkuj), operatorë dhe montues në fabrika dhe të makinerive (79% burra), e punëtorë zejtarie dhe tregtia e lidhur me të (78% burra).

Në krahasim me zonat urbane, dallimet mes burrave dhe grave në profesione si teknikë dhe profesionistë të asociuar janë shumë më të mëdha. Në zonat rurale, 37 për qind e të gjithë teknikëve dhe

**Tabela 9**

**PËRQINDJA E BURRAVE/GRAVE NË ÇDO PROFESIONA (NË %), SHQIPËRI, 2011**

	Zona urbane		Zona rurale	
	Burra	Gra	Burra	Gra
Shqipëria				
Ligjvënës, zyrtarë të lartë dhe menaxherë	75.5	24.5	85.0	15.0
Profesionistë	38.2	61.8	42.6	57.4
Teknikë dhe profesionistë të asociuar	50.4	49.6	63.0	37.0
Punëtorë për mbështetje administrative	50.7	49.3	65.0	35.0
Punëtorë shërbimi dhe shitjesh	59.1	40.9	71.9	28.1
Punëtorë në bujqësi, pylltari dhe peshkim	68.6	31.4	66.0	34.0
Zejtari dhe tregti e lidhur me të	78.3	21.7	91.2	8.8
Operatorë dhe montues në fabrika e të makinerive	78.5	21.5	87.7	12.3
Profesione të thjeshta	48.9	51.1	69.5	30.5
Forcat e armatosura	89.1	10.9	95.7	4.3
E paspecifikuar	61.8	38.2	54.8	45.2

*Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

profesionistëve të asociuar janë gra, ndërsa në zonat urbane, ato mbajnë 50 për qind të pjesës. Gjithashtu ka dallime të mëdha në zonat rurale në profesione të tjera si punëtorët për mbështetje administrative dhe punëtorët e shërbimit dhe shitjes. Në zonat rurale, gratë janë pothuajse të padukshme në profesionet tradicionalisht të dominuara nga meshkujt si zejtaria dhe punëtorët për tregti të lidhur me të, operatorët dhe montuesit në fabrika dhe të makinerive, dhe forcat e armatosura.

Punësimi sipas sektorëve tregon se gratë janë të përqendruara kryesisht në sektorin e shërbimeve dhe mbajnë një pjesë prej 42 % të këtyre vendeve të punës. Hendeku më e madh gjinor është në sektorin e industrisë ku gratë mbajnë vetëm një të katërtën e vendeve të punës. Ka një numër të madh grash që punojnë punë të papaguar në bujqësi. Puna e papaguar e grave në punësim në bujqësi, dhe pjesëmarrja e tyre e madhe në industrinë e shërbimit në krahasim me industrinë, është një tregues i pagave të ulëta për gratë. Gratë janë të përqendruara në sektorë dhe profesione që ofrojnë paga më të ulëta në krahasim me sektorët e dominuar nga burrat.


**Tabela 10**

**PËRQINDJA E PUNËSIMIT SIPAS SEKTORËVE, SHQIPËRI, 2011**

	Burra të punësuar mosha 15+	% pjesë	Gra të punësuar mosha 15+	% pjesë	Totali
Bujqësi	118,570	67.1%	58,175	32.9%	176,745
Sektori jo bujqësor:	314,208	62.7%	186,997	37.3%	501,205
(Industri)	103,267	74.7%	35,000	25.3%	138,267
(Shërbime)	210,941	58.1%	151,997	41.9%	362,938
Totali	432,778	63.8%	245,172	36.2%	677,950

*Burimi: Censusi 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*

Burrat në punësim raportuan se punojnë orë më të gjata sesa gratë. Dallimet mes burrave dhe grave në punën me kohë të plotë janë më të mëdha në zonat rurale, të cilat mund të jetë kryesisht për shkak të përfshirjes së madhe të grave në punë të papaguar bujqësore. Tirana ka numrin më të madh të grave që punojnë me kohë të plotë. Kushtet social - ekonomike të Tiranës si kryeqytet e bëjnë atë që të jetë një vend më i favorshëm për gratë në aspektin e mundësive për punë. Ajo gjithashtu ofron më shumë shërbime që mund të zvogëlojnë barrën e grave si kujdestare kryesore.

**Grafiku 25****ORËT E PUNËS, SIPAS SEKSIT, SHQIPËRI, 2011**

*Burimi: Censuri 2011 për Popullsinë dhe Banesat në Shqipëri*